


# HEJZA



VAÇE ZELA

**Njerëzit qanin dhe puthnin autobusin e pluhrosur, sepse brenda ishte artistja e tyre. Mbi metalin e pluhrosur mbeteshin gishtërinjë, simbolet e shenjat e tyre...**

Përtej legjendave

# PUSHTETI I ZOMBIT

Demonstrimin e pushtetit të ZOMBIT në mënyrë të përkryer e ushtruan oficerët nazi-fashistë. Ju kujtohet: një ushtar gjerman hipur në një motor e pushtonte një mëhallë, një katund, një qytezë! Të gjithë i nënshtroheshin! Ndryshe, për një gjerman të vrarë vriteshin 100 qytetarë të nënshtuar



Nga Avni HALIMI

ZOMBI është qenie që lind nga shpirti i njeriut i zhytur në trup të një bishe në çastin e vdekjes së tij! Me këtë rast, shpirti ndikon vetëm në shpërfytyrimin e bishës në pamje njeriu dhe jo edhe në zbutjen e tij. Njeri me tipare të bishës! Dicëka si vampiri! ZOMBI është kriesë për të cilin mendohet se ka vdekur dhe është ringjallur pa ndonjë qëllim e pa një gram dëshire për lir! Shih për këtë kjo kriesë e ulët kontrollohet nga BOKORI, ringjallësi i ZOMBIT! Kështu thonë mësimet e besimit VUDU. Psikiatria skoceze i ka kushtuar vëmendje të posaçme ZOMBIT! Sipas kësaj psikiatrie bëhet fjalë për një fenomen që manifestohet me skizofreni të përcjella me disa sëmundje të veçanta mendore. Ky zombifikim bën që, i sëmuri mendor, ta përceptojë dhe ta besojë veten gjarpër zot. Ndaj mësimet Vudu thonë se ZOMBI mund të asgjësohet vetëm nëse goditet në kokë, si gjarpri!

Frika as nuk mbillet as nuk korret

Në politikë ZOMBI përfaqëson diktorin, njeriun që nuk ngopet me derdhjen e gjakut të qytetarëve; njeri që farnë e vet e ngrit mbi metodat torturuese derisa qytetari të mos bindet se zot në tokë e në qytetarët ai, ZOMBI!

Në kohë paqe, ZOMBI imponon dhunshëm bindjen se është përfaqësues i tërë popullit të vendit, i popullit shumicë, ndërkohë që vendi mund të jetë i populuar prej më shumë popujve. Të tjerët janë qese gjaku, ku, përmes "puthjes së amshueshme" siguron përfjetësinë. Në kohë paqe, ata që nuk i përuken ZOMBIT shkojnë për lesh, ata që servilosën, të parët i bluajnë ushqim për ZOMBIN.

Luftë nuk ka në kohën e pushtetit të ZOMBIT. Me luftë në këtë kohë nënkuqtohet kataklizëm absolut! Në këtë kohë mund të ketë padëgjueshmëri qytetare.

Në kohëne padëgjueshmërisë qytetare vlejnë rregullat e luftës nazi-fashiste: për një - njëqind, apo, me raste, për një dyzet! Për një lëndim, për një vrasje, për një sharje, apo, për një moslargin nga komunikacioni kur këtë e do ndonjë kokëtullac i ZOMBIT, qoftë ky me emrin

alfa, beta apo gama (ZOMBI gjithnjë synon lashtësinë greke paçka që për këtë synim mund të humbë gjithçka, madje edhe veten!) do të bastisen dhjetëra shtëpi, do të keqtrajtohen qindra qytetarë të padëgjueshëm. Frika duhet të mbillet në palcë. Në kohën e ZOMBIT, palca është si një granit i pashkërmor, ndërsa frika si një bimë e butë, pa rrënje, që nuk zë as në lesh! Prandaj, te të padëgjueshmit, që kanë gjak kryeneç, frika nuk mund të mbillet, e as të korret. Frika të vdes! Kjo palcë e kurritit vertikal nuk mund të jetë as integruese e as të integrohet në projektet laboratorike të ZOMBIT.

ZOMBI në letërsi përfaqëson figurën mitologjike e cila tashmë është ngritur në metaforë që shpreh trishtimin, mynxyrën, dhimbjen e tmerrshme, makthin, ngulfatjen, vrasjen, therjen, prehjen e gjuhës, thithjen e gjakut, rrähjen, mohimin për ekzistencë, thithjen e ajrit të lagështisë, pushtimin e lirisë. Në letërsi Zombi shpreh gjithçka që është zi e më zi! ZOMBI "artistik" dallon nga ai Vudu-Zombi dhe nga ai folklorik-mitologjik. Popujt që e kanë përjetuar nën lëkurën e tyre fenomenin ZOMBI, ata këtë kriesë e përrshkruajnë si kriesë të urit përmish e gjak njeriu. Gjithnjë është në gjah të njeriut, i përgjargur e me shenja në trupin e dekomponuar. Është pa ndjenja e pa shenja personaliteti.

ZOMBI vetëm kur ka pushtet dhe në pushtet mund të jetë me këto virtyte antijerëzore, përndryshe, ngjanë në një milingonë! Ndaj e gjakon pushtetin, flijon gjithçka për të mbetur në pushtet, vret e pret! Në këtë shkallë të absolutizmit arrin vetëm kur ta bind popullin e vet se është shpëtimtari i tij. Kjo do të thotë se popujt e tjerë detyrimit duhet të nënshtrohen, sepse është i përzgjedhuri, i përkëdheluri dhe i përkrahuri i popullit të vet. Të gjithë popujt e botës duhet ta kenë të qartë këtë!

ZOMBI nuk mbinë si fara e keqe! Derisa të bëhet i përzgjedhuri i popullit ka punë! Fillimi bëhet urë për popullin, pastaj, vorbull për popullin dhe në fund kolovajze cirku duke i dhuruar popullit një kënaqësi deri në delir - rrrotullimi sa më i frikshëm aq më i lezetshëm!

"Zombët" si operativë

Disa mësimë pagane thonë se, në çastin kur trupi vdes, shpirti kalon në trup tjetër, kryesisht në trupa kafshës! Mësimet indiane shpirtin e njeriut e shohin të kalojë në trup të shqiponjës, ndërsa paganizmi i eurolindorëve pohon se shpirti i njeriut kalon në kafshë e shpendë, varësisht nga karakteri i atij shpirti; mund të kalojë në ari, në ujk, në kali i cili, meqë është i lindur për dru gjithnjë e legjitimoni dhunën, por edhe në patok të shpifur! Patoku është qenie e butë, e ëmbël, e lezetshme! Po cili mund të jetë patoku i shpifur? Pa dyshim, ZOMBI i sotshëm.

ZOMBI i sotëm, i plotpushtetshëm, të lë përshtypjen se ka ikur nga legjendat dhe është varur në akrepat e orës sonë! Sot ZOMBI vret e pret në emër të popullit! Jo, ZOMBI është i gjithëfuqishëm, ndaj ai nuk vret, as nuk pret por, me një urdhër, të gjithë vetëpriten, vetëvritten, vetëbastisen nëpër shtëpi që nga orët e hershme të mëngjesit, vetëkeqtrajtohen, vetëizolohen, vetëburgosen, vetëvarrosen! Këto veprime i fsheh nën rreshtat e mediave të cilat vihen nën shërbimin e tij! Ato media që nuk do ta shërbijnë, pronarët e tyre do të vihen në tapet!

Tashmë ZOMBI ka krijuar shumë "zombëz" (kalamaj të tij), që në gjuhën policeske do t'u thoshim "operativë" dhe, këta janë ato që kryejnë punë në terren. Këta "operativë" apo, "zombëza", nuk është me rëndësi a gjenjënë, a sajognë, a trillojnë, a rrabin, a burgosin, a vrasin - për ta me rëndësi është që ta përbushin kënaqësinë e ZOMBIT. Populli është i kënaqur me të! Madje edhe sikur të mos jetë i kënaqur, tashmë është i disiplinuar dhe ndjenë një "siguri" prej tij. Ndaj, Zombi punon në emër të popullit! Gjithësesi, në emër të popullit të vet, të tjerët janë veçse kot!

Është "jo etike" nëse do të përkufizzonim ZOMBIN, apo nëse do ta krahasojmë me vampirin irlandez apo me Drakullén runun, me gogolin karpatian apo me bajlozin oriental. Zombi i sotshëm është një konglomerat në mes të patokut të shpifur, rinoshit dhe shpirtit që pat fatin ta njerëzojë një bishë të

pangopshëm.

ZOMBI i sotshëm është i bindur se ka përkrahjen absolute të popullit të vet ndaj, për popujt e tjerë "që i administrojn" as që do t'ia dijë! Çdo kërkesë, apo çdo lëvizje politike të popujve të tjerë ai e perception si shigjetë të helmosur drejt popullit të vet. Në tender ka hedhur kërkesën për një mekanizëm disiplinues, i cili në praktikë merr trajtën e një aparatë të përsosur dhune. Fillimi bëhet, parinë e popujve të tjerë që i ka në pushtet të vet i fut në këta mekanizma disiplinor dhe pastaj, me pëlgimin e tyre të përshtiptshëm nis e ushtron dhunë mbi gjithçka! ZOMBI me shpatë mbi gjuhë, mbi mendje, mbi shëndet, në dyqane e në xhepa, në traditë e kulturë.

Të flasim me gjuhën konkrete dhe të shtrojmë një pyetje retorike: sot, një ZOMB i tillë, si do të sillej me shqiptarët? Sot Zombi shqiptarëve do t'u kishte mohuar të folmen shqip, ndërsa gjuhën ua kishte prerë me sëpatë, do t'u kishte përkeqësuar sistemini e arsimimit deri në analfabetizëm, do t'u shtrëmberton historinë kombëtare, në shërbimin shëndëtesor shqiptarët do t'i kishte trajtuar si kavie, në kulturë do t'i kishte trajtuar njerëz me bisht ndaj të cilëve në mënyrë permanente duhet ushtruar superioritet kulturor; në sport për t'i përdorur si të gjitha llojet e topave, në ekonomi për t'u vjedhur tërë kapitalin, në financa për mos t'ju dhënë asnjë lekë; në administratë për t'i lënë nëpunësit shqiptarë nëpër korridore e bufe; me flamurin kombëtar për t'u shënuar shtëpitë për bastisje, traditën për t'u marrë dinjitetin nëpër këmbë! Natyrisht, jo të gjithë shqiptarëve por, vetëm atyre që nuk i nënshtrohen pushtetit të tij. Ata që integrohen në pushtetin e tij zombian e nxjerrin "bythën në stom" dhe duke shijuar nektarin e rehatisë politike, derisa nuk hasin në mut, mbajnë syze te zeza në diell e në shi.

Në emër të cilit popull dënon ZOMBI

Pra, Zombi krijon aparaturë të përkryer dhune dhe, sa herë që dëshiron ta ngjallë frikën dhe të dëshmojë se është i fortë, e aktivizon atë mbi kurrit të popullit të papërmabjtor. Populli i papërmabjtor kurrë nuk rrësht së têrhequri vërejtje - ZOMB e tuprove!

Ata që e shajnë i ndëshkon me operacione poliore mëngjesit të hershëm të ditës, apo i burgos, ose i zhduk me nam e me nishan ose edhe i dënon me lekë. ZOMBI nuk shahet, për të nuk shpifet, ai nuk pështyhet, ai nuk urrehet - ZOMB urohet dhe duhet të ngritet në kult! Duhet të konceptohet si fuqi absolute, dëshirë kjo e çdo krijese të çorodit të Krijuesit Absolut.

Pasi populli t'ia falë besimin absolut këtij farë ZOMB atëherë nuk i mbetet asgjë përvëçse t'i përulet përfjetë. Me përlulje gjen sigurinë e plotë. Jo njëherë kemi thënë - do hamë bukë e krip vetëm të kemi paqe e siguri! Këtë e siguron ZOMB! Por, vetëm për ata që i nënshtrohen apo që integrohen në sistemin e tij të funksionimit. Të gjithë të tjerët, të gjithë ata që i bien grusht tavolinës së kundërshtimit, do të përballen me sanksione, dënimë, keqtrajtime, vrasje, rrahje, burgosje e zhdukje. Dhe, krejt kjo në emër të popullit.

Vërtet, në emër të cilit popull vepron ndëshkueshëm ZOMB?

# NJË DEVALVIM I PAMËSHIRSHËM, LEHTËSISHT!

Bajram SEFAJ

Pa u sjellë vërdallë e rrotull pas bregut, i bie shkurt e trup, in medias res: fjala, pra, këtu e me këtë rast, është për devalvimin e disa gradave, mjeshtërive, thirrjeve, profesioneve e zejeve e tjetra kësisoj, që, nga ana e të rinjve, përdorën si kollaj e pa përgjegjësi. Për shembull: nuk ka ditë, mbasë, as orë e dekik, që në shtypin tonë ditor të mos lexojmë, të mos shikojmë në programet televizive, a të mos dëgjojmë përmes valëve të radiostacioneve të shumta që sot, këtu e atje, u bë përvimi i këtij apo atij libri, që u shfaq premiera e këtij apo atij filmi, kësaj shfaqje apo atij spektakli teatror, e këshfu më radhë. Krejt kjo është një gjë e mirë dhe, besojmë, askush nuk ka asnjë kundër kësaj. Përkundrazi, të gjithëve, si një, na gëzon e mbush entuziazëm e krenari një gjë e tillë. Mirëpo, kur është fjala për autorët, këtu ka keqpërdorim, abuzim dhe devalvimi të pamëshirshëm. Le të quhet këshfu. Derisa tek muzika, artet pamore, por edhe te spektaklet teatror (e të ndonjë tjetër), kjo vërehet, më pak, ndërsa kur është fjala për shkrimitarë, poetë e regjisori, regjisori, sidomos të filmit, dukuria merr përmasa skandalozë!

Nëse jo përditë, atëherë lirisht mund të thuhet se, për çdo javë, në mjediset e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, në Prishtinë, në ambientet e tjerë, gjithandje, dhe nëpër qendra të tjerë komunale, bëhet përvimi ndonjë libri të ri. Shumë më rrallë, medet, përurohen veprat e një mendë letarë të shkrimitarëve të një mendët e, shumë shpesh, në anën tjetër, përurohen "veprat" e "shkrimitarëve" të ri, sidomos të "poetëve"

dhe "poeteshave" të reja. Pasi që marrin vlerësimë pozitive nga ana e disa redaktorëve mercenarë, (që të mbysin me émbëlsirat), që në promovim i lexojnë po ato shkrime që i kanë vu, ose në para ose në pasthënie të librave që gjëzojnë përvimin, bëhet kiameti në keqpërdorimin e pamëshirshëm i fjajës shkrimitar, poet, autor. Përdorimi i epitetave, plot lavde e saltanete, gjithmonë është në përpjessëtim të drejtë me sasinë e të lekëve të paguar për këtë biznes. Në të shumtën e rasteve, më shumë fjajë të mira (e të mëdha) thuhet, për këta libra të parë, se sa për vepër të spikatur të ndonjë autor i serioz e me renome, kur përvuron librin e tij të njëzet e më shumë. E, në anën tjetër, në përvimet e veprave të para letarë, në të shumtën e herës, të vëllimeve me poezi (e rrallë herë të ndonjë proze), fjala është përvargje të dërsitura, të shkollarëve e gjimnazistëve, të cilat vargje, një dreq e di

se nëpër duart e kujt (s')kanë kaluar. Me rëndësi është që nga mjedisi i përvurimit, i riu apo e reja, del me arealin e poetit, shkrimitarit, autorit. Që nuk ka dreq që ua heq mëndje dhe e (keq) përdorin orë e çast, deri në devalvim, dhe pa kurrfarë modesti! Jo, more, bacë, as me dhjetë e as me njëqind e dhjetë vepra të botuara, një autor nuk e merr epitetin shkrimitar, po që se në atë kallaballëk veprash nuk ka paksë vlera të një mendë artistike.

Po aq keqpërdorim ka edhe kur është fjala për përvimin e dramaturgëve dhe të regjisoreve. Në mjedisin tonë (herë-herë primitiv dhe provincial, pa dyshim), ai që ka ngatërrua disi (dosido) një tekst të një drame mezi një aktës, përnjëherë, zë vend në mesin e dramaturgëve! Por, por..., duhet pranuar se në këtë drejtim, më së largu, deri në neveri larg, shkohet me (keq)përdorimin e fjajës (zejes) regjisori! Pa i parë (shikuar) më as

dy filma të kujt do qoftë, që veprat e realizuara, më mund e djersë kreativitet, ia kanë dhënë atributin regjisori, ky regjisori ynë, mjafton të arnojë, keq, përgazep e faqe të zezë, diçka në yrnek filmi e vetën e vetë, ta quaj regjisori! Haj bela, hajt!

Jo, bre bacë, për t'u bërë regjisori, jo vetëm për vete por edhe për të tjerët, duhet prirë, pikësëpari, me një hop talenti, pastaj me një grimë shkollë (shkollim), akademik, (në ndonjë akademi botërisht të njohur, pse jo?) duhes bërë një stazh madje prej disa vjetësh si asistent, t'u shkosh pas thembrave jo, një e dy, por shumë regjisoreve të njohur vendës dhe të huaj, e tek, pasi që të kesh bërë një eksperiencë si regjisori i dytë, po, edhe i tretë, tek pastaj, me ndrojtje e modesti, të marrësh përsipër të realizosh ndonjë film artistik të lirë, që nuk kupton (harxhim) buxhet të trashë.

Kur është fjala për regjisoret e vetëquajtur regjisore, më së largu, deri në abuzim, shkojnë "regjisoret" e filmave dokumentarë. Edhe reportazhet më të rëndomta, çfarë kemi realizuar na të shkretit, ishe reporterë të TVVP-së, këta çunat dhe gocat e sotëm, pa fije turpi e ngurrimi, i quajnë filma, filma dokumentarë. E vrapojnë të (na) hedhin kripësyst me disa terme, postproduktion e të tjera që, zoti me vrafëtë ne ditshin as vetë, se ç'janë ato. Pastaj, festivalet e ndryshme, në të katër anët e botës, bëhet skrop, pas këtyre (krye)veprave të tyre e këshfu më radhë. Edhe një dukuri tjetër që, ngutej të hynte në kornizën e ngushtë të kësaj skice për ese, ishte ajo, për shkrimin dhe promovimin e monografive. Por, lidhur më këtë, një herë tjetër. Premtim!



## Kapërcimi i tranzicionit

# TAVOLINA SUEDEZE DHE SHIJA LETRARE

Para se ta kërkoj një qasje të lirisë nga ushqimi apo, siç thotë Fromi, liria ekonomike është një nga shkallët themelte të lirisë, më shkon mendja te Panairët e librit, të cilat nga viti në vit po shndërrohen në "tavolina suedeze të librit"

Afrim DEMIRI

Kujt si kujtohet thënia e Kadresë apo e shqiptuar për artin kadarenian se "shqiptarët (lexo: shqipëria shqiptare) në kohën kur nuk kishte ushqim të nevojshtëm, ushqehet me letërsinë më të mirë". Në ditët që u gjeta në një kompleks në vendin turistik me emrin aq metaforik, Mali i Robit në Golem, fillova të reflektoj përtëj ndjenjës së një robi, qoftë edhe turistik, dhe të mendoj se çfarë lidhje ka letërsia si ushqim i mendjes, me ushqimin e ngrënshëm. Kjo dilemë mori një sërë trajtash provokuese kur u përballa me tavolinën suedeze dhe nuk më shqitej nga koka koha e taloneve për ushqim, në Shqipëri, apo rreshtat për qumështin e Zajeçarit apo për Fax -in në Kosovë, krahës kohës kur flimim me librat e Kadaresë nën jastëk. "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Kush e solli Doruntinën", "Prilli i thyer" si dhe "Kronikë në gur", na u patën bë më shumë se bestseller. Gjithsesi e para gjë që mbizotërën është kapërcimi që ka sjellë tranzicioni, i cili me gjithë efektet pozitive, për shkak të transformimit demokratik, nuk po na hiqet prej trojeve shqiptare, duke sjellë edhe një zvetërim të vlerave sa humanitare po aq edhe estetike. I vështroj njerëzit me pjatat e mbushura dhe me befason stërbushja e pjatave, prej ullinjve të mbushur, llojeve të djathërave të bardhë deri tek ai pikant, pastaj sallatat e

përziemë, mos të harroj supat, dhe frutat e detit. Kur të gjithave ua shtojmë specat e mbushur dhe rizotot me mish viçi si dhe me peshqit e fërguar, atëherë vërtetë kjo pjatë e stërbushur njojë në pah kompleksin për ushqimin apo ndjenjën e kapërcimit të varfërisë. Para se ta kërkoj një qasje të lirisë nga ushqimi apo, siç thotë Fromi, liria ekonomike është një nga shkallët themelte të lirisë, më shkon mendja te Panairët e librit, të cilat nga viti në vit po shndërrohen në "tavolina suedeze të librit". Liria për të zgjedhur nuk di ku qëndron në raport me lirinë për të pasur pjesën e duhur, pjesën e nevojshtëm, që të mos ndodhë vërshtëm e panevojshtëm! Stërbushura e pjatave, pa asnjë kriter të përgjedhjeve, po e vë në një peshore shijen për ushqim, me shijen letarë. Në asnjë Panair librash nuk jam ndjerë i lirë, para syve grabitqarë të shitësve që shpesh janë edhe botues, kur nuk jam parë si njëblerës potential dhe asnjëherë si një lexues me kriter. -"Çfarë po shikon, ju kosovarët vetëm shfletoni dhe nuk blini", - ishin fjajët e një zonje që me trashësinë e saj ishtë zhytur në mes librash dhe pamja ime ia dëftonte më shumë një lypës rasti se njëblerës librash e mos të na shkon mendja te një krijues i mundshëm.

- "Si ta blejë pa e shfletuar", ia kthej unë, duke krijuar një mbrojtje "intelektuale" ndaj një shitësë të rastit. - "Dua ta di botuesin, të di

ma shumë për autorin, për përkthyesin eventualisht, për ndonjë parathënie apo pasthënie", vazhdoja, derisa ajo humbte durimin me mua. Vërtet ec e përcaktoku për blerje, mes një marketingu aq të fuqishëm, kur qëmnet e librave ishin proporcionalisht me famën e autorëve, kurse krijuesit e rinx ishin viktimi i marginat e tavolinave të stërbushura, kurse librat religjioz kishin stërkequr ata filozofik. Edhe aty vëreja njerëz që, për dallim nga unë, dillin me një krah librash që peshonin, të gjitha pothuaj se me mbështjellëse të dizajnuara, shpesh pa e ditur emrin e autorëve e lëre më përmbytjen e tyre! U shkonte për shtat anekdoda se blejnë libra me metër, varësishat e është gjatësia e vitrinave të tyre. Në anën tjetër, dallohen shitet e stendave, të cilët më përgjyanin në tregtarët e vegjël në Çarshinë e Baku-s, në Azerbejxhan, të cilët ta zinin udhën, të tertiqin për krahut që të futësh me çdo kusht në lokalin e tyre të mbushur me qilima të endur. O çfarë ngjashmëri, në mes shitësve të Panairave tonë me shitet azerë, i vërtmi dallim në mes situatave ishte se librat zëvendësonin qilimat. E njëjtë gjë më pat ndodhë edhe në Sarajevë, në skajin tjetër të ish-Perandorisë Osmane, kur kamarierët me fes të kuq në kokë nuk më hiqeshin që me çdo kusht të hyjnë në qebaptoren e tyre. Andaj, "tryezat suedeze", qofshin të librit apo të ushqimit, i shoh edhe si një përplasje

mentalitetesh, që vettetiu nuk funksionojnë si dorë e lirë e përgjedhjes, sepse përcaktohen nga sjellja qytetërese çfarë duhet të jenë ato. Dhe doemos duhet të mendosh se në kohën kur dinjiteti i një sofre të rëndomtë me një zgjedhje të varfër, mbasë nuk krahasonet dot me një gamë zgjedhjesh deri në plasje të plancit apo një vërtësim titujsh prej autorëve klasik e deri tek ata anonim, nuk mund të krahasonet me një moment diskret kur një libër e blerë me kujdes dhe përkushtim i dhurohej dikujt të dashur, sikundër blerja hulumtuese pas një shfletimi me plot pasion bëhej në një librari, të cilat po rrallohen nëpër qytetet tona. Andaj kah dhe si? Nëse duam, mund të provojmë ta transformojmë thënien e ndërlidhur në mes ushqimit dhe letërsisë. Ma e mës e së mirës do të ishte "ushqimi i mirë, për një letërsi të mirë". Por, shpesh ngjanë që e mës me të mirën débohen dhe dita ditës po binderni se po hahet më shumë e po lexohet më pak, dmth. po jetojmë në kohën kur "ushqimi është më i mirë, në kohën e një letërsie më të dobët"! Mbështetje duke e përjetuar ikjen nga leximi në njëren anë, e në anën tjetër tjerpinë për ushqimin.

Nuk mund të imagjinoh qëndrimin as përjetimin e Kadaresë në kohën e "tavolinave suedeze", por fakti që kohëve të fundit po heshtë më shumë se që po flet, po besoj se shijen letarë e ka stërholluar edhe më shumë!

Në shiritin e kohës

# VAÇE ZELA, KONCERTI I PARË DHE I FUNDIT NË PRISHTINË

Njerëzit qanin dhe puthnin autobusin e pluhrosur, sepse brenda ishte artistja e tyre. Mbi metalin e pluhrosur mbeteshin gishtërinjë, simbolet e shenjat e tyre...

## Hys SHKRELI

Vaçja, e kujtimeve te mia, po hynte në Kosovë për turnenë e saj të parë e të fundit në këtë vend. Viti 1979. Ajo Vaçë, atë ditë mësi, zbriti qetë si një flutur nga një kombi-bus i vjetër. U përqafua me ne, sikur të vazhdonte një përshtëndetje të filluar dekada më herët. Në atë moment, m'u bë sikur po takoheshin dy shekuj, dalë nga një popull. Aq e gjatë na ishte bërë ajo ndarje. Ne po prisnim në atë kufi, rrëth një gjysmë shekulli, Vaçë...

Kishim dalë në kufirin që atëherë quhej jugosllavo-shqiptar, për të takuar grupin më të madhe e më të njojur të artistëve nga Shqipëria, të cilët po vizitonin për herë të parë Kosovën. As qe kam mund të ëndërroj në atë moment që, një ditë do të lavdërohem pse isha unë ai që e pagëzova "kufiri shqitaro-shqiptar", e të tjerët e shpërndanë këtë emër.

Atë ditë, më ty Vaçë filloj shembja simbolike e kufirit. E vërteta, kënga jote e kishte kaluar e rrënuar atë kufi më heret. Ai kufi, atë ditë pranverë, dukej si toke e vdekur, tokë e askuj. Pa jetë e gjallëri. Aty s'kishte arrijtë pranvera kurr, shekujt ishin ndalur. Dhe kjo pamje dëshmonte se sa e thellë ishte kjo ndarje e imponuar midis Kosovës e Shqipërisë. Por, atë ditë, u ngjallë ai vend si asnjëherë më parë, më ty e të tjerët qe po e thyenit at mur, duke na sjellur këngëtarët e ndaluar - në Kosovën e izoluar. Vendkalimin kufitar e kishin vërvshuar banorë të fshatrave për rrëth, të cilët kishin dëgjuar për arrijtjen tënde e të artistëve tjerë të këngës. U dorëzuan para emocioneve...Të veshëm me lule e lot.

Ti po shkelje për herë të parë, në Kosovë. Mbështetje dije, qe ti kishe jetuar në Kosovë shumë vite - si këngë. Në atë karavan pos teje, ishte edhe Limos Dizdari, Gago Çako, Luan Zhagu, Liliana Kondakçi, Zina Zdrava, Hysni Zela, e shumë të tjerë, më të cilët ne jetonim në Kosovë, por kurrë nuk i kishim takuar. Ato vite, pas dekadave te izolimit, muri i ndarjes - po plasaritej. Në këtë klimë të re politike, artistët më të njojur të kengës nga Shqipëria, po fillon turnenë e tyre të parë në Kosovë e Maqedoni. Disa prej tyre, nuk kishin udhëtuar kurr më parë jashtë Shqipërisë. Për herë të parë po shkelin në një tokë të dytë - shqiptare. Ishin këto, yje të Shqipërisë të cilët ndriçonin edhe në Kosove, mirëpo kurrë nuk kishin shkelur në këtë vend...

Isha gazetar, por bëja edhe moderne spektaklesh publike të asaj kohe. Më ftuan të shoqëroja këtë grup dhe të drejtoi koncertet. Udhëtimi më artistët nga Shqipëria ishte udhëtim nepër kohe, dhëmbje e ngjarje. Mbushur më momente gjëzimi e gazmendi, por gjithnjë të përshkuara më situata prekëse e emocionuese. Ishte ndjenjë e çuditshme të celebrojsh takimin e shqiptarëve - më shqiptarët, rilidhjën e rrenjëve të shpërndara, ngjalljen e



urave të rrënuara, bashkimin e gjakut të shprishur.

Udhëtonim më autobusë, nga një qytet në tjeterin. Kudo që ndalësim, rruga bëhej lum njerëzish, lagja ngjalje, qyteti zgjoej. Zejtarët para dyqaneve, plakat në dritare, të rinjte më lule - sikur takonin ëngjyjt e ëndërruar. Mirëpo, në çdo turmë, kishte ndonjë nga "ata", për të kontrolluar shprehjen e asaj, që politika e quante "manifestim i nacionalizmit". Ndaj vërehej së kishte edhe dashuri të kontrolluar, posacërisht kur njerëzit flisin më fytyra e jo më goje. Kur goja heshte e sity, mëmrika, e shpirti flisin. E dinim se çdo eufori e tepuar, do te rezultonte më limite të reja nga pushteti jugosllav. Ndaj, edhe në këtë emociione kishte vetëpërmbytje, vetëcensurë.

Në vendet e palestra ku këndonit ju Vaçë, njerëzit prisnin më lule, mall dhe zjarr. Të ekzaltuar, ata xhvishnin këmishat e xhaketat dhe u vinin flakën. Digjëshin këmishat, digjëshin ndalesat, e zemrat. Digjëshin ndarjet e kufijt. Ato koncerete, ishin kremltë dhe protestë. Simbolikisht, ata po digjin kohën e politiken qe ndau kombin. Ndaj, ato tubime nuk ishin vetem muzikore. Ishte ai vit i çmalljes së madhe shqiptaro-shqiptare... Shoqëronte Orkestra e Madhe e Radio-televizioniit te Prishtinës. Me vjen keq qe s'mbaj mend drejtuesit e Orkestritës, por di se Severin Kajtazi, Isak Muqollë, Krist lekaj...ishin nder më të

angazhuarit. Kjo Orkestër, për herë të parë po shoqëronte solistë nga Shqipëria, ndaj të gjitha orkestrimet duhej pregaditur, dhe luajtur drejtëpërdrejtë para publikut apo "live", siç do të thonim sot.

Vaçë Zela. Kur dëgjova se je bërë luleborë e Alpeve të Zvicrës, pranë Aleksandër Moisiut, m'u ngjall ajo Vaçë të cilën, e takova në atë pranverë të hershme, ulur në një autobus të bardhë (të "Turist Kosovës"), duke pushtuar me sy luginat e Dukagjinit e Majat e Bjeshkëve të Nëmura... E shoh edhe sot atë fytyrë dhe ata sy, që thithnin nga dritarja ato peizazhe të vendit të cilët i kishte kënduar e kurrë nuk e kishte parë. E kur autobusi më këtë karvan të këngës ndalej, atëherë krijoreshin imazhet ikonike që preknin shpirtërat. Njerëz të emocionuar rrëthonin autobusin dhe preknin atë metal të ftohtë, duke kërkuar dorën tënde, Vaçë. Policia i shpërndante dhe nuk lejonte hapjen e dyerive. Të rinj të emocionuar puthnin autobusin, pse ti ishe brenda Vaçë. Gishtërinjtë e lotët e tyre, linin gjurmët mbi autobusin e pluhurosur që na e zinte frymën në ato momente. Ata shkruanin vargun e tyre për ju... Ti, Luani, Limosi, Hysniu e të tjerët, përpinqeshit t'i fshihni lotët e ta ruani buzëqeshjen. Shqiptarët qanin për shqiptarët. Për një çast, harroheshin të gjitha këngët. Ata ishin aty, jo vetëm për ty, dhe jo vetëm për hir të këngës. Ata donin ta takojnë Shqipërinë e ndaluar. Donin të bëhen

dëshmitarë të historie të re. E Shqipëria ishe ti, në ato momente. Ata po takonin vendin e shkëputur prej tyre, e ndonjëri edhe rrinë e shënuar me këngët tua. Nga ata që prisnin, kishte edhe njerëz të cilët kishin bërë burg për një këngë tënden ose të këngëtarëve të brezit tënd. Për gjeneratat e sotme, kjo pamje, vështirë shihet si e tillë... Shqipëria, në atë kohë ishte shumë, shumë larg. Ti udhëtovë gati dyzet vjet, për të arritur në Kosovë.

Vaçë Zela, sot kujtimet e mia për ty, më sollën nga pertej Atlantiku. Më këtheyn në qytetin e vogël të Therandës (Suaharekës). M'u ngjalle Vaçë, në atë drekën e parë që patëm së bashku në restorantin "Ballkan". Aty ishim pakëz më të izoluar nga publiku, ndaj biseduam për shumë gjëra, por jo edhe për ato që na interesonin më se tepërmë. Për ato, nuk të pyeta e as nuk më pyete. Sepse e dinim se rrëth nesh ishin "ata". Sa herë që biseda janë bëhet më e afërt, ndonjëri nga "ata" afrohej e ndërrhynte me ndonjë pyetje të pakuptimtë. "Ata" ishin edhe nga ana juaj, edhe nga ana jonë. Nga Sigurimi i Shqipërisë dhe Sigurimi Jugosllav. Pak a shumë, ne e dinim cilët janë, ndonjëse ishin të karmufluar në profesione të ndryshme. Ishte ndjenjë ngulëfatësë të flasësh pa fjalë. Të ndjesh dikë aq të afërt, por të mos mund të bisedosh lirshëm. Fytyra plot shprehje e goja memce. Aty dëgjova më tepër për jetën tende. Mësova që ishe nuse e Kosovës, siç do të thoshin vendasit e mi, pasi bashkëshorti yt kishte rrënjet nga Janjeva. Ti kupto më mirë se sa e njojur dhe e respektuar, ishe në këtë vend të cilin po e zbuloj. U befasove kur të thash se, në këtë anë të Alpeve, të quajnë Mirej Matje shqiptare. Modestia jote, të bënte edhe më të madhe se që të dinim.

Lëxova fytyrën tënde dhe shihja përplasjen e ëndrrave tonë mbi Shqipërinë e panjohur. Lëxova veshjen tënde të thjeshtë, por elegante dhe bëhesha skenë e jotja. Dëgjoja fjalën tënde dhe tërë ato këngë të njoitura, bëhesha dialog i asaj dite. Unë kisha njëmijë pyetje, ti pa dyshim, shumë përgjigje, por i heshtëm dhe ia lamë kohës. Pastaj, shikoja fytyrën e Agron Çobanit, i cili ju printe, asokohe drejtor i Radio Tiranës. Fytyra e tij, më ngjallte tregimet për shqiptarët të cilët, burgosur nga pushteti jugosllav, vetëm pse kishin dëgjuar haptas Radio-Tiranën e ndaluar. Jeta e shështë plot ironi. Ai rrinte i heshtur dhe askush nuk e njihet, sepse ishte ti Vaçë, ajo që të njihet dhe donin të të takojnë. Po bisedonim sikur njiheshim prej vitesh edhe pse kurrë nuk ishim parë.

Gjenerata ime ishte rritur më këngët tua. Ne qe kishim vizituar Shqipërinë në atë kohë, e dinim se "Valsi"yt i lumturisë nuk ishte për lumturinë e atyre viteve, por, vals i një lumturie të imaginuar - që mungonte. Kënga jote për "Diellin e ri", kishte një porosi universale e optimizëm njerëzorë. Do të mund të këndohej në çdo kënd e çdo

gjuhë të botës.

Ditët tona së bashku, pasuroheshin me ngjarje, biseda, e humor. Limoz Dizdari, Gago Çako, Luan Zhegu e të tjerët, kishin sjellë me vete jo vetëm këngët, por tërë sharmin e fshehur të Shqipërisë. Duke e njohur pak a shumë gjendjen në Shqipëri, unë gabimisht kisha fituar përshtypjen se atje, njerëzit nuk kanë kohë për të qeshur. Mirëpo ju, me barsoletat e tregimet tuaja, e rrënua at mal dyshimi, dhe na bëtë të ndjehemi si një familje që po jetonte në bashkësi me vite. Ato ditë, e bëmë një Shqipëri të Bashkuar, një Shqipëri të Madhe sa kënga jote.

Në çdo qytet qe vizitonim shpërthenin vullkane admirimi e dashurie për ju. Por, ndeshnim edhe ndonjë befasi të pakëndshme. Gadi në çdo sallë ku ti do të këndoje, na priste Titoja i varur në mur, si një mumje. Zyrtarët nga Shqipëria kishin kërkuar që të largohet fotografia e këtij diktatori. Ky ishte qëndrim më të cilin nuk bëshesh kompromise. E njëjtë irregull vlenë për artistët nga Kosova në Shqipëri: Fotografia e Enveri nuk guxonë të ishte në sallë. Ndaj, pyetja më delikate ishte se, kush do ta largojë Titon, e kush Enverin - nga koncerti. Disa herë, kjo çështje gati solli ndërprenjen e turneut.

Udhëheqësit lokal, kishin frikë ta largojnë.

Në momentet e fundit gjithnjë gjendej dikush i "gjithëfuqishëm" që Titon e nxirre jashtë. Zakonisht e lagonin gjatë kohës së drekës, kur salla ishte e zbrazët, qe të mos dihet kush.

Njëri prej atyre që merreshin më këtë punë ishte udhëheqësi i atëherëshëm i Radio Prishtinës Shaban Hyseni, të cilit ia kishin besuar kujdesin për çështjet e nxehtha politike. Ndonëse atë e akuzonin si titoist, ishte ky ai që zakonisht e nxirre Titon nga salla. Shumë vite më vonë, Titoja nga varri, iu hakmor Hysenit; E shkarkuan nga puna dhe të gjitha funksionet, pse kishte larguar fotografinë e Titos në sallat ku këndonin artistët nga Shqipëria.

Si një korb mbi kokë, na rrinte presioni i imponuar nga censura e autocenzura. Njëra vinte nga pushteti, e tetra nga droja që të mos t'i thyejmë regullat e imponuara. Duhej matur çdo fjale që flitej, posaçërisht para publikut. Çdo këngë, tekst e konferencë, kalonte nëpër lupën e censorëve nga të dyja palët. Tani, kishim censorët nga të dy dikturat.

Eprorët e tu, më këshilluan që modernimin ta bëj sa më zyrtar. Ata kritikuani pse moderimi im, sipas tyre, dukej pakëz perëndimor. Më këshilluan që të mos e ngrë zërin, kur shqiptoj emrat e artistëve, sepse kjo ua kujtonë moderatorët italian, stil ky i vlerësuar si modernist e borgjez në Shqipëri. Nderhyri edhe cenzura kosovare. Pasi që në atë kohë, dygjuhësia në Kosovë ishte e obliguar në tubime publike, më thanë që do të duhej të përshtedesja publikun me një fjali edhe në gjuhën serbokrate, ose ata do të angazhonin një moderator serb. Nuk di, nëse ky një provokim. Nëse publiku serb, vjen në koncerte të Vaçe Zelës, atëherë bisedojmë për çështje, sugjrova unë.

A të kujtohet koncerti në Prishtinë? Na the, se as në Shqipëri, nuk kishe përfjetuar momente te tillë. Ishte ngjarja më e madhe skenike që kishte parë Prishtina, në ato vite. Në Palestrën e Sportit, ku mbahej koncerti, po takoheshin të gjithë lumenjtë shqiptarë. Njerëzit nga rajonet, kishin

ardhur për t'i lidhur dekadat e shkëputura nëpërmjet zërit tënd. Ti e ndeze Prishtinën dhe ua shkunde rrudhat atyre që kishin filluar të vjeshtohen e nuk shpresonin që një ditë, do të të kenë në skenën e qytetit të tyre. Këngët e tua i dhanë një shpirt të ri atij qyteti. Sot, sikur i shoh imazhet e nënave që sjellin edhe foshnjat e tyre për t' u fotografuar me ty, të bindura së ato momente nuk vijnë më, por bëhen histori. A të kujtohet gazetarja që ndërpren intervistën me ty, sepse nuk i përbante dot lotët..

Njerëz që kurrë nuk të kishin takuar, nëna, gjyshe hynin me fërmijë në dhomën tënde prapa skenës dhe shtangoheshin kur të shihnin: Ata qanin - ti qaje. Kishte diçka të çuditishme, gati hyjnore në ato përqafime. Herë-herë, u ngjanin takimit më dikënd që sapo ka dalë nga burgu. Disa, si të hipnotizuar qëndronin para teje e t'i puthnin duart. Nuk flisnin shumë. Lotët u zinin vendin fjalëve. Dhe, këto skena përsëriteshin pa ndërprenje.

Atë natë, ajo sallë u bë lulishtë. Njerëzit prej ngado sillnin lule për ty dë këngëtarët e tjerë. Në fillim, lulet u dorëzoheshin artistëve, mirëpo papritmas kjo ndryshoi... Pastaj kuptova se tufat me lule, kishin një sekret brenda. Njëri nga "ata" (të Sigurimit të Shqipërisë), m'u afroa dhe më dha një si gjysmëurdhë: "Lulet do t'i pranosh vetëm ti, jo artistët dhe do t'i sjellësh në zyrën tonë..." Ai donte të linte përshtypjen se kjo ishte çështje e sigurisë, mirëpo shpejt zbulova të vërtetën kur gabimisht hyra në dhomën e "atyre" dhe vërejta lule të shpérndara nëpër dysheme. Po kërkoni diçka midis luleve. Vetëm atëherë kuptova se njerëz nga publiku, hiqnin stolitë e arit nga trupi, dhe i fshihnin midis luleve për të ua dhuruar artistëve në skenë. Çiftet, po dhuronin kujtimin e shenjtë të kurorës së tyre - unazën e martesës, por Sigurimi po i merrte ato.

Ishte ajo gjëja më e vogël e mirënjohjes admiruese që mund të shprehnin ne ato momente për ju. Urdhrin për lulet, kryesisht e injorova duke aktuar ngathësinë. Sepse, nuk mund të grabisja lulet që ishin sjell për ju, as stolitë e unazat që kishin dalë nga duart e adhurueseve tuaj, për ty e të tjerët...

Vaçe Zela. A të kujtohet mbrëmja e fundit para se të ndahemi në Ohër? Nata e fundit në Hotelin "Metropol", ku kënduam, festuam e qeshëm deri në mëngjes. E në agim, si një këmbanë, na ngriti në këmbë Gago Çako me thirrjet e tij nga tarraca e hotelit, më tërë zërin që kishte... "Ooo Selimoooo"... Thërriste Selimin nga njëra anë e Ligenit të Ohrit në tjetrën. E dinim se Gago kishte pirë pakëz raki, por nuk ishte i dehur. Thërriste me tërë zërin. Kush është Selimi, u interesuam ne?

Gagoja, sqaroi se, matanë ligenit, në Poradec, paska një kolegë ushtrie që quhej Selim, si duket nuk kishte kujtime të mira me të ..." Dua t'i them atij, ja ku jam unë e ku je ti", shtoi ai. Gagoja, për herë të parë e ndiente veten më i fuqishem se Selimi, i cili, si duket e kishte spinuar ose maltretuar Gagon në ushtrit. Një orë më vonë, Gago Çako, dhe të tjerët, ishin përftej ligenit, në anën e Selimit... Ne që mbetëm në këtë anë të ligenit. E veshëm pikëllimin. Të dy palët po ktheheshim në botët e tyre të ndara. Shqipëria e Madhe e Këngës, të cilën e ndërtuan gjatë atyre ditëve, përfundoj. Sérish u nda në dysh. ("Illyria")



Ali Aliu për poezinë e Rudolf Markut

# POEZIA E STATUSIT GRI: MUNGESA E KUDOPRANISHME


(Çfarë kishte shkruar Ali Aliu për vëllimin poetik të Rudolf Markut "Një ballkanas në Londër", Toena, në vitin 2013)

Në librin më të ri të Rudolf Markut, ajo që vjen e veçantë është titulli "Një ballkanas në Londër" dhe distanca shtatëmbëdhjetë vjeçare nga libri i parafundit i këtij autori "Vdekja lexon gazetën" (1995). Në takim të parë me titullin, lexuesi mbasë edhe mund të nxitet për të brendhur në kërkim të veçantive mes dy hapësirave, mund të niset në kërkim të karakteristikave të njeriut, të botës së ballkanasit dhe londinezit, të ambientit e rrethanave dalluese mes tyre, - le të themi edhe mes qendrës dhe provincës, e kështu me radhë... në këtë ecje, lexuesi, ende pa e hapur librin, do të prirej të gjiej përparësitë, përkatësisht mungesat e njërsës përballë tjetrës: pasurinë shpirtërore, të pakonsumuar të ballkanasit dhe asaj të qendrës së harxhuar, të shtetur, përkatësisht përparësitë e vlerave, resurseve shpirtërore, konvencat e shtresuara ndër mote dhe të kundërtën, tjetësimin e tyre, në fryshten edhe të përplasjeve globale. Pas leximit të librit, natyrshëm lihen anash këto ngasje, por që, në mbështetje mbasë edhe të reflekseve të tillë, të paktën mes vargjesh, mund të shfaqen nxitje përsiatje edhe nga perspektivat e sferave dhe fushave të zëna ngoje më sipër...

Në krye të regjistrat, pas leximit të parë të librit me poezi "Një ballkanas në Londër", gjithsesi zë vend përshtypja mbi përditshmérinë e zërit lirik nën ngarkesën e vërmisë, mbi vërmënë e shtrirë dhe të pranishme në të gjitha lëvizjet dhe perspektivat e tij. Ndjehja e vërmisë u jep shijen dhe ngjyrën mëngjeseve dhe mbrërmjeve, ecejakeve dhe takimeve të këruara apo të rastit, miqësive dhe dashurive, bërdhjeve sidomos nëpër Evropë... Vëtmia u jep kuptim e pakuptimësi kujtimeve, - tërë çështë e shkuar dhe shpresave që radhitën si ditë të nesërme, përditshmérinë e mbërrthyer mes tyre. Tërë ky disponim gri, ndërkaq, në poezinë e Rudolf Markut nuk vjen lament dramatik i papërlallueshém, por një prani konstante, etablim fryshtëmarrjeje, përditshmërie, vjen përcaktim, pakt i prerë rrethanash, mbasë fatesh... Vjen mall dhe mërzi e kullandrisur, e kultivuar estetikisht, por që pakti i nënkuqtaur së jashtmi, në sipërfaqe, arrin ta përcjellë dhembjen e tulatur, e pashërueshme në brendësinë e zërit lirik...

Malli ngasës dhe dëshpërues, është vatra e parë e tensionit dëshpërues e ekspcionit të përbajtur gjatë bërdhjeve nëpër vërm. Çdo gjë përreth në këtë bërdhje vjen jehonë e kohës së shkuar bashkë me tretjen dhe asgjësimin e bukurisë dhe e gjëzimit, vërsim dhe shfrim i kudopranishém nga i cili nuk ka si të mbrohet, si të rigjendet zëri lirik. Nga thellësítë qoftë a nga pritet kohore, nuk arrin asgjë lumturuese, pos boshit shurdh dhe tjetësimi përreth. Çdo gjë vjen nga një largësi pa kthim.

Vatra kryesore e kësaj ndjenje, e vërmisë, duket të jetë boshi i një brak-



tisjeje dhe një mosgjetje. E thënë kështu tingëllon si një përgjithësim që sthotë gjë. Poezia, arti, mbështetet mbi këtë ngasje, -mungesën, mungesë besimi, shprese, èndrre, dashurie... Te poezia e Rudolf Markut, mungon trualli, shtëpia e ngjizjes, ambienti që e ka lindur, formuar, brumosur, mungon thelbi - me tërë kohën dhe hapësirën tanë të largët, të ikur, të tretur në pakthim: tanë të shndërruar në art poetik, i vërti ngushëllim, përkatësisht kënaqësi sipërore e artistikë, e zërit lirik...

Por ikje s'ka, gjetje s'ka, kthim s'ka! Dhe në këtë çast më vjen ndër mend një poezi antologjike e Kavafit me titull "Qyteti", të cilën dëshiroj ta sjell të plotë me këtë rast:

The: "do shkoj në tjetër tokë, do shkoj në tjetër det."

Një tjetër do të gjendet se ky qytet më i mbarë,

Ku çdo përpjekje më qenka një dënim fatal;

Dhe është zemra ime si një i vdekur e varrosur aty.

Gjer kur mendja do më mbetet në këtë ligështi?

Ngado që të vështroj, ngado që syrin kthej

Rrenime të zeza të jetës sime këtu gjej

Ku kaq vite shkova dhe prisha e bëra shkretë.

Vende të reja s'do të gjesh, s'do gjesh dëte të tjera.

Qyteti do të të ndjekë. Të njëjtat rrugë do të kthesht.

Dhe në të njëjtat lagje do të gjesh strehë;

E në po ato shtëpi do bëhesh flokëbardhë.

Gjithnjë në këtë qytet do të mbërrish. Se gjetkë-shpresë mos mbaj-

anje nuk paska për ty, as rrugë nuk do të ketë.

Kështu siç e bëre jetën tënde shkretë

Në këtë fole të vogël, në tërë botën e prishe përngaherë.

Te Kavafi pra, ikje-kthimi përbën një rrëth dëshpërimisht të mbyllur. Fat-dënim në qytetin e lindjes, nga i cili provon të ikësh e s'mundesh, të cilin e braktis dhe e bart me vete vulë, vragë të brendshme. Në rrapotje për ti gjetur shtigjet e kthimit nëpër botë, në kërkim të qëtësise, prejves, drejtpe-shimit të brendshëm, e derdh, e konsumon kot, e shprish edhe atë bartje të folësë së dikurshme, thelbini... Dyfish humbës, sipas poezisë, vizionit poetik dhe filozofik të Kavafit... Por le të na lejohet të kthehemi, - sa brenda parabolës ikje kthimi, ku ngjizet dhe artikulohet majë artistike vetë poezia e Kavafit "Qyteti", tek disa nga poezitë gjithashtu antologjike të vëllimit "Një ballkanas në Londër", që janë dëshmi se "jeta e shkretë nga folaja e vogël" nuk është "prishë përngaherë nëpër botë"! Le të shohim si duket, si artiku-lohet çarja e pakalueshme mes dy brigjeve, në njëren nga poezitë më të realizuara, te ketij libri "Balada e njeriut që nuk dua ta njoh": "Një njeri vjen mëngjeseve në dhomën time", "Nuk thotë asnjë fjalë", "Asgjë nuk thotë", "vendoset në një kënd të dhomës Sendet nga shikimi i tij kanë të ftotë". (...)"Ai kurrë se ka parë bukurinë e hënës", "Vetëm kur ngrihet nga gjumi vonë", "Kujtohet se netëve", "ka pasur hënë"... "Ai nuk beson tek gjérat", "Si mund ti besojnë gjérat atij?..." "Unë them se ai nuk duhet të flerë", "Kur hëna është e bukur në prill". "Ai është njeriu që nuk dua ta njoh" "Dhe e njoh aq mirë"..." Si mund të bëhen bashkë pra këto dy palë të unit lirik, duke përfjashtuar

njëra-tjetrën përfundimisht!?

"Era" është një tjetër kryevepër e këtij vëllimi, është një tjetër variant metaforik i po asaj mungese gjërryeze, i atij malli dhe asaj vëtmie pa ngushëllim. Është era që fryshtuar kudo dhe nga kudo, ortek që shemb dhe rrënon pengesa, furi që përplaset mureve të veta dhe kthehet sërihimi dhe sërihimi prapë. Ç'është, ç'kërkon ojo? Të hapë dritare, dyer të mbyllura hermetikisht, botën, zemrat, të kaptojë male, dete, qiej dhe të mbërrijë-ku? Të fshijë nga faqja e dheut mallin, dhembjen, kohën, hapësirën? Shpërthen ajo tejetëj, s'ka fuqi që i vë pritën, që e pengon, ska mbrojtje prej saj... fryshtuar ajo nëpër pafundësi shkretëtire, pa pengesa, e këndej çdo gjë mbyllur, kyçur, dyer, dritare, zemra...

Mungesë-vetmi sjell si ikja (qyteti i braktisur apo që të braktis), si gjakimi për kthim. Shndërruar në rrëfim poetik, në art që ndriçon mungesën gjërryeze, mallin sfilitës, vëtminë ulëritëse, në botën e zërit lirik vazhdon të mbetet e hapur varra dhe ta ushqejë atë, poezinë, njësoi si kraharori në gjoksin e nositit të Lasgush Poradecit. Është përfitmë i stuhishëm vizioni i mungesës, si prani e asgjësë, e hiçit që fanitet rrënuar çastesh gjëzimi, lumturimi, shembje urash kthimi, shtyllash mbështetëse. Edhe më keq, vjen iluzion, në çaste se mund të ringjallet gjë nga ai fluid eterik i memories. Sado që zëri lirik përpëlilitet në mëtim për një mbështetje, jo rrallë duke kërkuar strehë në çaste intime... Nuk ka asgjë më të pranishme në poezinë e Rudolf Markut tek libri "Një ballkanas në Londër" se mungesa. Mungesë është çdo gjë përreth, e tëra çfarë ka, mungesë vatre, mungesë hëne dhe muaji prill, mali e deti, mungesë shtëpie dhe sokaku me kaldrëm, e dashura e parë, zëri, hija e babait, mungesa në këtë lirikë të përsosur është një fuqi që lëviz male e shkëmbj, lumenj dhe erëra, që lëviz universin e zërit lirik...

Një atribut i mundshëm që gjithashtu do tu qëndronë vargjeve të këtij vëllimi poetik, mund të jetë: mall për një botë, për një kohë që nuk ekziston më, përkatësisht mall për një botë të munguar shpirtërore, mungesë e një vatre të njëherës, të ngrohtë dhe të dashur, mall për shtëpinë e lindjes dhe njerëzit përreth, - artikular në art poetik të përsosur. Bota, rruga e kaluar, sa më përcëllues që vjen dhe ngacmon si kujtim, siç ndodh në poezinë e Rudolf Markut, aq më gjërryes artikulohet malli, përkatësisht aq tokë e shpirt i thatë shtrihet bota e tanishme përreth. Këtyre përmasave bërdh dhe vuan vëtmia në librin poetik "Një ballkanas në Londër". Në lirikën e tij, bota e brendshme është refleksion i botës përfjashta që vjen valëzim ezoterik. Refleksioni autopoëtik vjen fizionomi dalluese, e veçantë, nuk i ngjan kujt, pos rrëshqës së zemrës së vet, e shpirtit të aftë dhe të pasur ta përballojë sfidën dhe ta ruajë qenien e vet, ta ushqejë

vibrimin e pashtershëm të thesarit shpirtëror. E etshme kjo botë shpirtërore e Rudolf Markut përmiqësi, përdashuri, prandaj vargjet poetikë në këtë vepër hapin shtigje, gjajnë lehtësisht rrugë hapje.

Pra përkundrazi: duke na dhuruar art poetik, vlerë, zëri lirik vazhdon ta thellojë, ta acarojë deri në dramatizim vërminë, përkatësisht mëton dhe arrin njëkohësisht çlirim nga mbërthimi i brendshëm i saj, mëton dhe arrin pastrim nga ngarkesa e mëkateve, e pleksjes së vetes në thurjen e rrugës së ikje-kthimit, e rrëthit të rrugëllur. Natyrish kolovitja mes kujtimi ndërrimt dhe realitetit konkret, e sjell buzë papërballueshmërisë ankthi vetmi. Ndërgjegjësimi i tij se një gjëzim i gjetur apo i rigjetur në shtëpinë globale është përfundimisht i pamundur, ndjesi që shtrihet në shpirt si gjallërim estetik i mallit dhe melankolisë gjatë tërë rrëfimit lirik përbën thelbën e vëtmisë së ankthshme. Është fjalë për botë lirike që në rrapotje për ta kthyer të pakthyeshnën, mëton edhe drejt një pakti me realitetin çfarë është. Në momente, diskretshëm, jo vetëm e kaluara, por çdo gjë në ecje e sipër tretet për të mos u kthyer, duke lënë pas vetëm jehonën e rrjedhës flurore të lumit, fishkëllimën rrëqethëse të erë-stuhisë si përfime mbi kokatona, mbi majat e maleve...

Drithërimë poetike dhe mallgërryes për të munguarën në pakthim është gjuha e kësaj poezie me burim ngasës nga universi i mistikut dhe dashnorit, i ikësit dhe kthyesit, i gjetësit dhe humbësit, gjithë për të mbajtur gjallë varrën. Vjen drithërimë e lehte e megjithatë ngulçitëse përballë tjetësimit dhe shkretërimit të shpirtit dhe që, prekur thellësitë, lëshon, herë-herë përshkëndijime metafizike. Pas përplasjeve mureve të padepërtueshëm, rebelimi tërhiqet në prehje, dhe atëherë shtrihet, si një vello e lehtë, konstante, mërzia, për të cilën Leopardi thotë se është "më sublimja e ndjenjave njerëzore". Kjo ndjenjë sipas tij vjen nga të kuptuarit se "gjithçka është shumë pak", është vetëm "një vogëlsirë përballë aftësise së vetë shpirtit", thjesht mërzia është "të vuajturit për ndjenjën e pakënaqësisë për boshësin që të ofron realiteti".

Valë vetëtimash, dridhje dhe regëtimë e brendshme vjen shtysa poetike e Rudolf Markut, bota e shpirtit dhe e mendjes së zërit lirik, vjen trajtë sublime e qenies së tij. Në momente vjen tërmet i brendshëm, shpërthim dhe shfirim çasti që rishtazi, me delikatesë subtile, ekuilibruese, pa lënë rrënoja gërmadhash dhe humnera të pakalueshme mbrapa. Nuk vijnë lëvizje tektonike apo qellore si të rastit, incidente të shkëputur: vinë valë që i japin kuptim-pakuptimësi çdo gjëje në botën dhe jetën e zërit lirik. Në këtë kontekst, poetika e kësaj lirike, e shquan, e vë në dukje individualizimin e zërit, e kthjellëson diskursin poetik së brendshmi. Pa as më të voglin hezitim për ta fshehur ankthi vëtmi, shtrirjen gri mbi çdo gjë që lidhet me përditshmërinë e tij; të theksuara qartësisht edhe bredhjet kryqetërthor, nëpër Evropë dhe mediterran sidomos, kërkimin e ethshëm të rrugëve drejt Itakës, përkatësisht rrugët për të ikur sérishmi dhe sérishmi nga Itaka... Diskrecioni i zërit lirik te poezia e Rudolf Markut as së largëti nuk priret drejt përvojave të fshehjes,



të hermetizmit trend kalimtar i çdo epoke poetike, por ai është vetëm dhe vetëm në funksion estetik, përmashash dhe mjetesh që nuk shkojnë përtëj këtij objektivi të zërit lirik.

Zëri lirik në poezinë e Rudolf Markut, duke bredhur në kohë dhe shpirtërimëve dhe shumësive, krahëve të iluzionit dhe deziluzionit, krahëve të pranisë dhe mospranisë së objektivit, veprimeve dhe mosveprimeve, krahëve të qenies dhe mosqenies, përkatësisht duke relativizuar kufijtë e duke i ngritur rishtazi ata, vendos më shumë qendra dhe perspektiva perceptimi kreativ dhe emocional mbi botën, mbi kohën dhe

hapësirën, kujtimin dhe mallin, vërmënë dhe vuajtjen, mërzinë dhe brengën, si poet dhe filozof... Perspektiva nga majat e lashta historike e mitologjike, vjen me funksion e gjakim përngjasimësh që i sjellin të kthjellëta qartësisht përmasat, raportet mes universit shpirtëror të zërit lirik dhe atij total. Përmasat përqasëse të absurdit dhe pamundësisë, të mungesës së pariparueshme në botën e zërit, përkatësisht sa më i qartë vetëdijesimi i tij për këtë status të pandryshueshëm tanë më, ndjelli, sjellin në memorie bëma e personazhe nga thellësi të tilla, sa përtë ndriçuar, por edhe për të marrë pjesë në dhembjen e poetit... Po me

Është krejt e dukshme, se poeti me një mjeshtëri të rrallë ka arritur ta transmetoj lëvizjen e subjektit nëpër situata pasigurie, ankhët dhe lemeri të cilën gjendje e unifikon në ligjërimin e trajtës së dramacitetit, gjendje kjo ku edhe pse dyzohen të kundërtat; ëndrra dhe zhgjendirra, dashuria dhe dhimbja, si dhe vjetvetja dhe tjetri, në fund patjetër do të

ndodhë kulmi i dramës: ëndrra dhe zhgjendirra, edhe njëra edhe tjetra, janë plotësisht reale. Janë realitet nga i cili buron vetëm Dhimbja. Është kjo mjeshtëri e rrallë e kombinimit të reales dhe sureales, që dëshmon fuqishëm origjinalitetin krijuar dhuë të rrallë artistik të poetit Xh. Bajra.

Ai gjithashtu, ka arritur sukseshëm që me motivimin tematik të mallit të bëjë strukturim të fuqishëm kuptimor i cili me trajtësimin e tij në simbol, arrin përmasa të gjëra kuptimore edhe pse me një gjuhë shprehëse emocionale krejt të natyrshme, për të mos thënë fare të ftohtë. Madje ajo që duhet të theksohet, është se në këtë situatë artistike poeti ka arritur të racionalizoj bindshëm përparrësinë e poeziës simbolike, karshi asaj tradicionale, sepse në një motiv që konkret dhe të trajtuar aq gjatë, vërtetë shprehja artistike arrin të bëhet kulmore, falë kryesisht natyrës simbolike të poeziës. /diku në dhe të huaj / fusha e kujtimeve çel lule me fytyra njerëzish/ Shi për këtë; "Maja e vetmisi" fq. 46.

Me këtë rast mund të konstatojmë pa hezitim se poeti ka arritur të transmetoj bindshëm faktin, se poezië e tij si poezi simbolike në radhë të parë karakterizohet me fuqizimin e poeticitetit të brendshëm duke sakrifikuar, gjegjësish aneksuar

poeticitetin formal në masë evidente, sepse esencialisht dhe kuptimisht do ta varfëronte dukshëm poezinë e tij, në raporte intervepruese të konsistencës formale karshi asaj përbajtjesore.

Prandaj, kujtoj, se pikërisht natyrës krijuar të këtyre vargjeve iu shkon bindshëm parafrazimi i V. Hygoit, i cili për poezinë simbolike në një rast shkruante se, është; "Ligjërata në ligjëratë".

Të natyrës së ngjashme gjithashtu vazhdojnë të jenë më tej, poezi "Grim i vdekjes" fq. 48. Apo "Kohë e ndalur" fq.49, etj.

Ndërsa qëk poezi "Në Vitrinë morti" i dedikohet, tmerrit të luftës së fundit, tragjedisë sonë, ku poezi të shquhen për nga mëvetësia motivore, të cilat edhe pse të ndërlidhura aq natyrshëm mes vete, secila ka në vete dramacitetin e saj, por që mendoj se unifikimi i tyre, si një model në tërësinë e njësive është rezultat i spontanitetit ligjërimor poetik të poetit Xh. Bajraj, që është karakteristikë esenciale e gjuhës së tij krijuar.

Konsidero se edhe pse pretendimi i poetit ka qenë kryesish të poetizoj brenda strukturës së poeziës, ky cikl për nga tërësia rrokë përmasat e dramës si gjini letrare, çka e bënë edhe më të vecantë poezinë e tij, duke e shquar edhe më, individualitetin e tij original artistik. / kjo poezi s'është e imja/ këto vargje i kanë shkruar ushtarët e armikut / e imja është veg dhimbja/ Shi përkëtë "Odë ushtarëve të armikut" fq.65. Apo poezi "Ftohtë", fq. 83, ku poeti thotë; "/bën kaq ftohtë /brenda zemrës së njeriut.

Ndërsa në poezinë "Dikur dhe tanë", fq. 171, kuptojmë se gjithë jetë e poetit Xh. Bajraj, që vetëm një bredhje, Kosovë, mërgim, propët kthim në Kosovë dhe përsëri, mërgimi në Mexico City, që dëshmojnë se lumturia për te ndoshta ishte vetëm ai kërkimi i njeriut të tij të ëndërruar, që në fakt unë nuk arrita ta gjej dot, as në leximin këmbëngulës që i bëra librit të tij. //Derisa shkruaja poezi për ditët që kurrë nuk erdhën /. Apo më tej ku thotë; "në një gjuhë tjetër shkruaj vargje për ditët që kurrë nuk do të kthehen/ në një gjuhë tjetër e kërkoi bukën në shitore.../ tanë/ dhemb jetë / Shi përkëtë, po aty, fq. 171.

Marrë në përgjithësi mund të thuhet lirisht se poezië e poetit Xh. Bajraj, në tërësinë e saj shpërfaqet si poezi e sensibilitetit specifik, e cila brenda për brenda me variatet e saj arrin të funksionojë në një harmoni të natyralizuar simbolike dhe gjuhësore ku realja dhe surealja marrin trajtë të veçanta kuptimore estetike

Sipas një filumit këtë shkrim, me poezinë përkërkimin e njeriut të lirë, duke bërdhur librit "Copaime e Qiellit", mund të përfundojnë se poeti kurrë nuk e përfjetoi lirinë, në kuptimin e lirisë së ëndërruar dhe të kërkuar. U dha me tërë qenien pas saj, brodhë shumë në kërkimin e saj, sikur pas ndonjë "Utopie". Ishte dhe mbeti poet i Parajsës së Humbur, të cilën nuk arriti ta gjejë kurrë, mbapse Trëndafili gjithmonë do të ngelë me gjemba dhe njeriu nuk do të gëzohet dot. Çastet e tmerrit nuk ndodhin vetëm në ëndërr... Pasi që në fakt ajo është zhgjendërr...

Nisur nga ky parafrazim i poetit, ndoshta njeriu i këngës së tij, nuk ishte ëndërr... nuk ishte as personifikim... por ishte vet ai..., që as ai e as ne nuk arritëm ta shihnim të lirë... kushti... apo një pretendim tjetër me synim për të një më i saktë. Liria, ëndrra për Lirinë, njeriu që do të Lindet i Lirë, është dhe mbetet një kërkim përacë e poetëve në vazhdimësi...

Përndryshe ky shkrim do të mund të përballyej fare natyrshëm me poezinë "Kati i shtatë" të librit poetik "Copaime e Qiellit" si një lloj epilogu, për njeriun e këngës, apo përvet fatin e poetit, ku ai thotë: " / Në katin e gjashtë shoh /një zog brenda kafazit/ që kishte vdekur buzë këngës së vet/.

# RAPORTET MES REALITETIT DHË ËNDRRËS

(Rreth romanit -ese, SIKUR, të Vera Vasisë)

## Agim BAJRAMI

Të lexosh romanet e Vera Vasisë do të thotë që së bashku me ta të lexosh ditarët dhe ëndrrat e pashkruara të dhjetëra e mijëra grave dhe vajzave të sotme, të cilat falen çdo ditë para ikonave të dashurisë të tyre të ëndërrta, si para ikonave të një kishe. Nëse do të hulumtonin trupin rrëfimtar të prozës së saj, do të konstatonim me kënaqësi një prani të dukshme indesh drite dhe shprese, të cilët emetohen natyrshëm edhe tek heronjtë e këtyre veprave. Në këtë linjë edhe romani "Sikur", i cili vjen mbas shumë romaneve të mëparshëm të saj si: "Qershi në kohë lufte", "Letra nga qilli", "Fustani i Polinës" etj. merr përsipër pasqyrimin e këtyre figurave në një laryshi kontekstesh kohore, por në të njëjtët raporte hije drite në rrethet vicioze të rutinës përditësore dhe ambienteve të ashpër maskilist. Parë në këtë këndvështrim mes heroinës gendrore të romanit dhe ambientit të saj aspak mikpritës, ekziston gjithmonë rreziku i rënies në kurthin e fshehtë të rutinës dhe melan-kolisë. Ndaj, e vtmja zgjidhje për t'i ikur kësaj, mbetet krijimi i një mikrobote individuale dhe mbushjes së saj me fantazi dhe ëndrra të guximshme. Është një proces jo i lehtë, që jo të gjithë ia dalin në krye. Edhe pse në pamje të parë personazhet e këtij romani ngjan se notojnë në "ujëra të qeta", situatat që përfjetojnë ata, janë krejt ndryshe. Personazhi kryesor i romanit, një vajzë me botë të gjërë dhe kërkuese, e ndjen se po zhytet si pa kuptuar në kurthin e rrafshët të monotonisë dhe zhveshjes së vetes pak nga pak nga tiparet më qenësore të personalitetit të një gruaje, fenomen me të cilën janë mësuar kaq shumë shumica e moshatareve dhe kolegeve të saj. Mbasi ka përfjetuar pasojat e rënda të braktisjes nga bashkëjetuesi, shqisat e mbi-ekzistencës së saj tashmë janë bërë më të mprehta dhe më reaguese. Kështu, duke bashkuar në një të vetme, forcën e fantazisë me atë abstraguese, ajo ia del të krijojë brenda saj figurën e një burri të ëndërrt, një personazh sa fluid aq dhe fizik, sa i padukshëm, aq dhe tokësor, çka i jep jetës së saj të tjerë dimisione.

Edhe pse një personazh atipik që vepron në rrethana tipike, prania e tij i ka dhënë këtij romani eseistik një rrjedhë interesante. Nga faqja në faqe ky duet i çuditshëm do të hyjnë gradualisht nën lëkurën e njëri tjetrit, aq sa në një moment të caktuar identifikimi i tyre, do të jetë një mision i vështirë. Natyrishët një identifikim i tillë artistik, i ka shkuar më për shtat autores të shpalë kredon dhe shumësinë e koncepteve të saj për tema dhe ide të caktuara, që kanë të bëjnë përgruan dhe konceptet e saj për jetën. Është kjo arsyja që në ravigjëzimin e tyre të dominojë më shumë dialogu i mprehtë dhe të folurit simbolik. Është forca dhe rezatimi i tij, që gjenerojnë energji te personazhet dhe mendimin qendror të veprës. Fantazia dhe e vërteta, e pazakonta dhe enigma, janë kuarteti që do t'i ndeshë vazhdimisht gjatë rrugëti-

mit tënd të gjatë në këtë veprë. Heroina e veprës dhe koha e saj, e kanë lidhur veten dhe fatet e tyre me këngët e singerta dhe vizionin për të nesërmën, që hap ndjenja e dashurisë për njerëz që e çmojnë dhe shenjtërojnë atë me veprimet dhe përkushtimin e tyre. Pohimi i veprës se një femër fantazinë e saj e përdor për të treguar dhe jo për të dashuruar, është një ftesë hulumtimi. Është e qartë se me krijimin e personazhit virtual të burrit të ëndrrës, këtij individi plot botë shpirtërore dhe humane, autorja krijon njëherësh edhe modelin interesant të një mashkulli, kaq të ndryshëm dhe të civilizuar, përballë bashkëkohësve të tij arrogante dhe cinikë me gratë dhe të dashurat e tyre. Vera Vasia është një autore që eksperimenton herë pas here në brendinë psikologjike të personazheve të saj, me mjetet dhe mënyrat e saj artistike. Linjat e shkathëta me të cilat vizatohen ata dhe ngjyrat e ndezura që reflektojnë, i bëjnë kriesat e saj sa interesante, aq dhe të afërt për ne. Janë individë që karakterizohen gjithmonë nga ngutja për të tejkular kornizat e arealit ku janë mbyllur dhe rendja drejt së resë. Nga gjithë karakteristikat e shumta individuale, që mbartin personazhe të tillë, duket se kjo është më evidentja.

Figura e Danielës të befason me energjinë që reflekton, por edhe me statujën e saj reflektuese.


"Më duket se vdes çdo ditë nga pak", thotë ajo në një nga dialogët e saj të shpeshtë me mikeshat që e rrëthojnë, si për të treguar gjendjen në të cilën ndodhej.

Masa e kohës ishte bërë si bllok, ku shënohej një datë dhe shkrimi vjetore, aq sa nuk lexohej më. Ajo ikte vjedhurazi dhe kërkonte të fshihej aty ku mendimi se perceptonte si masë, përkëdhelej, duke humbur kështu mes ditës dhe natës dhe vrapi për ta arritur ndale te një shikim përtëj qillit, për ta prekur atë në finish. Le mbrapa një kohë dhe gjete një tjetër. Gruaja që përfaqëson ajo është një frymë, që buron nga zhgënjimi prej absurdit dhe kërcitjes së dhëmbëve të ankthit. Ajo nuk sëmuret nga sfidat e dashurisë, sepse i është mbushur mendja top se: Dy njerëz bëhen viganë, kur mes tyre përfjetohet ajo çfarë mund të duket e vogël dhe e pa rëndësishme. Danielën e bashkon me të harresa, por e ngacmognë PSE-të e shumta të arealit. Atë dhe personazhet e tjera gra të kësaj vepre i bashkon dhe i bën të ngashme me njëra tjetërën klithma e heshtur që bartin në buzë dhe ndjenja e protestës,

ndaj së tashmes të përjashtuar nga drita dhe të nesërmës që s'premtan shumë. Kjo është një lloj ngasje, që ajo bëhet pjesë e shqetësimeve dhe pakënaqësive intelektuale. Personazhes që lëviz si një kohë e humbur në faqet e romanit të saj, i ri shumë i ngushtë ky areal, ajo nuk ka nge të merret me pikëpyetjet, dyzimet dhe PSE -të e gjata të dyshimit. Synimi i saj primar nuk është pasqyrimi i dramës, por gjurma e plagës që lë ajo tek individë të vegantë nga mos kurimi në kohë.

"Njeriu se kupton dot sa shpejt vjetrohet një letër dhe cili është fundi që mbetet nëpër gishta". Në një atmosferë të tillë uniformiteti dhe mungesë ngjarjesh, shoqëria e saj vetëm me mbetje ëndrrash dhe copëza vëtmish, do të ishte vërtetë e rezikshme dhe pa rrugëdalje.

Ndofta ka qenë presioni i tyre që e shtynë atë të nxjerrë nga sirtarët e fantazisë prej gruaje figurën e ëndërrt të një burri, i cili pak më vonë do të shndërrohet në një të dashur virtual. Dhe pse me shpërfaqje fragmentare, pesha e pranisë së tij është e rjafthueshme t'i krijojë rrëfimit të saj sigurinë e duhur dhe asaj vetë, gjysmën e munguar. Në një farë mënyre vepra e Verës mund të konsiderohet edhe një vepër e mungesave të mëdha dhe dëshirave të refuzuar. Vizatimi i kontureve të tyre në shkallë dhe proporcione të ndryshme, shoqërohet nga një përdorim efikas metafore. Burri -ëndërr, nëse mund ta konsiderojmë kështu, është jo vetëm një premtim për lumturi virtuale, por edhe rikthim në përmbytjen. Edhe përpos dëshirës së saj për ta mbajtur disi larg syve të tjerëve, bukuria e tij fizike dhe shpirtërore depërtón mes nesh me logjikën dhe ligjet e përhapjes së dritës, duke orientuar kësijoj lidhjet dhe zgjidhjet e mëtejshme të fateve të personazheve. Autorja nuk bën eksperimente me stilin, por kujdeset që të përcjellë te lexuesi sa më qartë reagimet e njeriut nën peshën e një drame shpirtërore, në një mijedis aspak mirëkuptues. Ngjan se gjatë procesit të gjatë shkrimor autores i është kujtuar Kundera dhe një nga thëniet e tij të njoitura se: Të njojësh bukurinë e një femre me një vështirim të thjeshtë, nuk është asnjëherë pak, por art. Elokuenca gjuhësore dhe ndërkalljet efikase të elementeve të esesë me poezinë e shqetësuar qytetare, i jepin forcën e duhur komunikative dhe ritmike rrëfimit. Një gjë e tillë i jep më shumë ritëm dhe elegancë rrëfimit. Në këtë këndvështrim duhen parë dhe trajtuar edhe ndryshimet e herëpashershme të humorit dhe portretit të personazheve, veshur si gjithmonë me lumturi dhe zhgënjime të vogla. Romani, ashtu siç e ka të qetë fillimin, të tillë ka dhe mbarimin e tij. Një mbarim plot ngjyra të gjalla si siluetë e një fustani të kuq, plot flutura dhe sinonime të një vallëzimi qiellor. Në fund, si plotësim i këtij vallëzimi, vjen edhe pohimi entuziazist i protagonistes kryesore të kësaj vepre me vlerë se: Jeta e gruas është një qell i pafund dashurie.



# POEZI E MENDIMEVE DHE EMOCIONEVE NË DIMENSIONIN KOHOR

(Arif Molliqi, "Si kripën të kam dashtë", "Armagedoni", Prishtinë, 2018)

Majlinda ZORBA

Kur ndeshesh me titullin kaq popullor Si kripën të kam dashtë, të vëllimt poetik të autorit Arif Molliqi, vendoset një raport i ngrohtë dhe i afërt komunikues me autorin, duke krijuar përfytyrim rreth ményrës së shkrimit, si dhe përfshihej nga ngasja poetike për lexmin e tij. Vëllimi në fjalë fillon me një poezi të veçuar me titullin Kronika e një fotografie. Çdo fotografi për poetin përmblehdh gjarje jetësore të shënuara, gjendje shpirtërore të papërsëritshme, që mbeten të sendërtura përgjithmonë. Fotoja është një vizatim me dritë që ekspozon një kohë të caktuar mbresëlënëse që mund t'i drejtoshë sa herë të duash për ta risjellë në kujtesë.


Fotoja që i përgjigjet kohës së ikur të rinisë i ndjell atij keqardhje, pendesë, mungetësë dhe e fut në meditime poetike. Poeti e krahason atë me foton kur ai mbuluar thinjash është duke synuar të dallojë dy kohë në antitezë të fuqishme që jetojnë paralelisht tek ai me efektet e tyre lirike. Kjo poezi krijon një rrëfim më vete, të spikatur dhe dukejet se është fort e dashur për poetin. Në këtë, si dhe në të gjithë veprën kemi fjalë çelës të një fjalori letrar: terr, kohë, ferr, parajsë, vdekje, vetmitar, engjëll, djall, plagë, farë, varr, tym, mjegull, portret, ngjyra e zezë dhe e kuqe etj., si dhe publicistikë e kinematografikë: foto apo si fjalë e plotë fotografji, film, letër, kronikë, antenë, televizor, ngjyrat bardhë e zetë. Motivi i mallit, kujtimet, nostaljia, trishtimi, éndrrat, lidhur këto gjithmonë me dimensionin kohë, do ta përshtojnë si një fill i kuq gjithë veprën. Poeti, nisur nga uni i vet ekzistencial, është i bindur përfundit me një pafiqinë njerëzore... me borën e bardhë mbi kokë... frytet e mërdhita dhe përfundit me kohës që ikën me revan përparrë, duke marrë me vete sekretet e jetët e secilit e duke mos u kthyer më përtë ta.

Asociacioni i mendimeve

Mes epitetit kohëmatësi dhe metaforës éndrrat janë plakur vëmë re asociacionin e mendimeve dhe të emocioneve në dimensionin kohor. Në këto poezi autori rreh të shkruajë në ményrë sa më koncize, e përgjashme kjo me një prirje të përgjithshme të poezisë moderne, duke i lënë hapësirë lexuesit të mendojë e imaginjoi në ményrë aktive. Ndërsa po të gruponin fjalë të fjalorit me karakter kohor, ato janë të shumta (kryesisht ndajfolje), dhe nëse do ta bënim pëmën e mendimit, do të spikatnë vargje të shpehshata që karakterizojnë kohën në shumë cilësi e anë të saj: Ora e plakur me akrepë të lodhur (Ora e plakur), këtu me anë të metaforizimeve del në pah ecja e zvargur, kur është fjalë t'i rrëzojmë paragjykimet që janë shqetësuese për poetin dhe këtë ai përipiqet ta kthejë mes vargjesh të shkurtër në bindje përllexuesin.

Diku tjetër Aty ku zura pritë, "...nuk e di ku ikën vitet e mia, a në tokë a në qelli, në hapësirën bosh midis një vjeshte e një dimri", ikja e kohës kthehet në shqetësim 42 e pasiguri për poetin, "... stina e mjegullës", "ishin ditë të lëna peng nga një kohë tjetër, me antena televizori bardh e zi", "ndër vitet që bëhen shkuk".

Te poezia Letra e humbur... derisa u rishfaq në një të martë me datën trembëdhjetë..., vjersha "Në ndërrimin e moteve", "... në mundsh për një vit ta ndalësh hapin... nuk bëhen i mençur assesi, kur dikush mundohet ta ndalë



kohën". Vetë letra si mjet komunikimi që konservon, ashtu si dhe fotografia kujtime, ndjesi, dështime e zhgënjime, pendesën dhe mundësinë që ajo fal për t'i kuptuar gabimet e hershme që mund të ishin zgjidhur ndryshtë: Një ngjarje e vrugët. Ndërsa në poezinë Vajzës që i pëlqente shiu, "...pas asaj nate që eci nëpër shi, duke u munduar ta shpëlajë një njollë të zezë në trup, mbetur nga kohë e keqe, nga një njeri i panjohur (asociacioni e panjohura në kohë e njerëz), te Më thuaj a të marr për dore, "...në sy, në gjoks, ka portretin tim, që ma vodhi vjeshtën e kaluar". Ndërsa në poezinë Bukuri e egër, "...ajo edhe sot është e bukur, ka pamje të quditshme, vite që s'i plaken kurrë, në Imagjinatë e zbehtë", "...kisha menduar se ajo ishte kohë e shpifur, kohë për t'i frikësuar vetmitarët që ecin natën".

Perceptimi i faktorit kohë

Libri hapet me poezinë Kronika e një fotografie e cila mund të themi se luan rolin e një prologu në hyrje të tij, duke i bërë të ditur lexuesit për një ngjarje që ka ndodhur më parë dhe që nuk trajtohet në vepër, po 43 që lidhet me të tërthorazi. Pas prologut kemi pesë nënndarje: E para Përsëritje e papërsëritur, e dyta Si kripën të kam dashtë, e treta Për dhimbje ka prova, e katërtë Fshati me një refugjat, e pesta Mjegulla në kryeqyjet. Bie në sy përdorimi disa herë i grupit të fjalëve Përsëritje e papërsëritur si nënndarja e parë e vëllimit, si titulli i poezisë së dytë të nënndarjes së parë, si një varg i poezisë Në kavernat e lirisë, "...i përsëritur në një kohë të papërsëritur" dhe si titulli i poezisë së shtatë Përsëritje e papërsëritura të nënndarjes së fundit me titull Mjegulla në kryeqyjet. Ky grup fjalësh ka faktorin kohë së brendshmi, ndërsa te Libri i amzës, "...mes dy poleve të tokës, në këtë kohë gjithçka ndodh", "Në kavernat e lirisë", "... koha ka të drejtë të përqeshë, ky është fati ynë, i përsëritur në një kohë të papërsëritur", këtu poeti e shpirtëzon kohën, e personifikon atë duke e bërë pjesë të pandarë, déshmitaren e vetme të paanshme përfundit që ndodhin, së cilës i jetet kësijo e drejta edhe të gjykojë e ta gëzuar jetën me të dashurën e tij.

Në poezinë Prova e një ore vlen të përmendet fjala "kohë" e parë në shumë

anë. Vihet në dyshim saktësia e saj: "... ora është e saktë kur i numërojmë numrat, shpesh ndodh i gabojmë vitet, s'na del asgjë e saktë... në Ballkan është prishur numëratoria, janë ndryshkura akrepat e orës, janë lodhur durimet... as dita dhe nata nuk përfundojnë me orë... është gjë e shëmrtuar kur dëgjon tik-takan cinik, kjo orë e përbaltur, zhveshur deri në lëkurë, s'na hyn në punë as kur lahet shtet". Këtu poeti sikur luan me orën, e percepton kohën në mënyra të ndryshme, edhe si një kohë reale, edhe si një kohë artistike, pjesë e subjektit mendor. Për të rëndësi kanë: ndryshimi, e reja, pozitivja, të cilat i dëshiron me pasion t'i shohë në realitetin ballkanik por, fatkeqësish, ora e ndryshimeve përmirë nuk vjen, se ajo është e plakur, ka tik-takan e saj cinik. Përbaltja e orës është një metonimi e spikatur ku mjeti zëvendëson ngjarjen, punën që është bërë mbrapsht. Koha e parë konkretisht nga poeti duket si një hollësi e mërzitshme, e parëndësishme por, në fakt, ajo merr një nëntekst të fuqishëm ideor në suazën e kontekstit të përgjithshëm. Në një poezi tjetër Ishte vonë përtë thënë diçka vargu i parë ta jep përshtypjen se kemi të bëjmë me një lajmërim në gazetë apo një faqe ditari: "... sot me dymjë e shtatëmbëdhjetë, ditë e shtunë dhe vjeshtë... këtu e tutje u besoj vetëm vdekjeve, kjo s'na u dashtë kështu, ngaqë koha na e la hingëllimën e tepërt, në kuptimësitë tonë i lamë të hyjnë të tjerët, dhe në librin e harresës i vurnë vetes pikë (në memorie të poetit është çdo gjë që lidhet me kohën, kur ajo që e ka dashur më tepër me zemër ka vdekur, trishtimi përtë në paralelizëm figurativ me kohën përshtikon gjithë poezinë, i lënduar që koha i mori me vete të dashurën, po më shumë i lënduar përgjidhjen e gabuar që dikur i kanë dhënë të dy bashkë, si dhe fundi tragjik simbolizohet me hingëllimën e kohës së pamëshirë që s'i dha shansin përtë gëzuar jetën me të dashurën e tij.

Në Shënimë nga Shkupi, "... pas dymjës vjet më pas erdhë djalli me zhurmë", poezia Ligjëratë dashurie: "...dashuria sështë kohë e pathënë, as dhimbje që harrohet, (çdo gjë ndodh me një arsy e fortë që e përmban vetë koha. Le ta kujtojmë Kantin, sipas të 45 cilit, koha dhe hapësira janë forma të ndjeshmërisë sonë, jo realitet që jetojnë nga vvetetja dhe të

pavarur nga subjekti ndijor.

Ky citim e përbush më së miri komentimin e raporteve kohore me ndjeshmërinë e krijuesit; i veçantë është përdorimi i faktorit kohë në vjershën Peizazh ndryshtë që nis: Kohë, shpëtoje kohën, derisa zogu këndon në kopsht e më tutje... shpëtoje nga fjalët e pathëna... kohë mëshirëmadhe bëhu, mos më shkund nga pema këtë natë, nga pema e veshur me mantel malli. Krijuesi ndjek të njëjtin procedim artistik me anë të fjalës kyçë "kohë". I drejtohet asaj që ta shpëtojë kohën, duke e llogaritur atë një herë si qenie reale, konkrete, në të cilën ka mbështetur shpresat dhe një herë si një kohë e largët, universi vetë, i gjithë kozmosi. Në këtë vjershë ka lirizëm të ngrohtë, ka mall e nostaljji, ka butësi në kërkim të mëshirës (kohë mëshirëmadhe - epitet metaforik, pema e veshur me mantel malli - personifikim dhe epitet metaforik).

Te vjersha Kthimi ose braktisja e gjumit, "... pak pas orës tre... në orën pesë të ditës së pasnesërme" mendoj se në këtë rast mund të shmhangeshin dy vargje të tila që mund të zëvendësohen me fjalë të tjera që përcaktojnë vështirësinë. Diku tjetër Më ngjan se ata udhëtojnë pa e ditur fundin, krijuesi e mbyll poezinë: "...gërryej me këmbë e duar kohën që më ka mbetur. Me këtë metaforë folje cilësohet ngarkesa e njeriut me shumë probleme e angazhime. Tek-tuk ka edhe deklarime apo thjeshtëzime të kohës, nëse do t'i quamim kështu, rastet kur përdorimi i saj i tepruar e prish bukurinë e poezisë, po në shumicën e poezive procedimi artistik me këtë noacion është realizuar më 46 së ploti, duke i dhënë ngjyrime simbolike dhe metaforike të larmishme, duke shtuar shkallën e emocionalitetit dhe duke u plotësuar edhe me një tematikë të pasur e duke përguar mesazhe bashkëkohore.

Ky autor përbën një individualitet të veçantë për vetë përvojën jetësore që ka edhe si një atdhetar i lidhur ngushtë me Kosovën: Kthimi ose braktisja e gjumit, Epitaf për kufirin, Te kulla e Zhlepit, Loja me litar, me arën e babës: Era e arës së babës, me Llukën e Epérme, vendlindjen e dashur Llukë e Epérme, I rikthej lojërat nëpër rruget e fshatit, me Lumëbardhën që nuk është më: Vrasja dhe vdekja e Lumëbardhit, me heronjtë e demokracisë: Ibrahim Rugovën, Jusuf Gërvallën: Heshtje e zhurmashme, Përvjetor, me Salih Çekajn, Agimën, Xhemalin (Në Koshare me Salih Çekajn, me shokët e shkollës, me Sadik Mulliqaj, motrën e dashur që sështë më (Loja e dhimbjes, Motërmadhës), me Çamërinë, Aleppon, Shkupin, (Lamtumirë Çamëri, Aleppo (Haleppo), Nata e anktheve, Shënimë nga Shkupi, si dhe me atë të mërgimtarit, përtë cilën krijuesi ka bërë një nënndarje të katërt të vëllimit me gjashtë vjersha (nis me Fshati me një refugjat e imbaron me Malli përtë bahu më ftoj). Te poezia Kthimi ose braktisja e gjumit autorit llogarit me kohën: "... është mëkat i shpëlarë, kapërcim nga stinët e vdekura... kërkonim dashuri stinëve shtëupe... s'di a kam kohë t'i ujis thëngjijtë e shuar nga djersa.

Dallohen përlirizëm të theksuar: Kënga e quqapikut, Vrasja dhe vdekja e Lumëbardhit, Më thuaj tu marr përtë dore, Era e arës së babës, I rikthej lojërat nëpër rruget e fshatit, Midis dhimbjes e të tjera. Zemërimi dhe herë 47 herë rebelimi i autorit për politikanët që e kanë zhgënjyer popullin, i kanë shitur interesat e tij, e

kanë copëzuar vendin pa mëshirë, arrin që të derdhë në vargje të gjithë millefin e dufin e brendshëm të shpirtit të ndjeshëm prej poeti: Politikanët, Rekuierin inati, Kjo kafshë e zezë, Kryeqyteti i krimbane, Në esencë ti bën sikur jeton, Epitaf për kufirin, Te Kulla e Zhlepit, Promenadë veriore apo limonadë kulturore. Në disa vjersha dalin çaste trishtimi, keqardhjeje, vëtmia e refugjatit, malli përfëmijet e gruan, letrat që u shkruan atyre, boshillëku shpirtëror në vend të huaj etj., por nuk mungojnë edhe notat e optimizmit, apo tragjizmit, edhe deklarimet, thënia troc e së vërtetës herë si një këshillë e nxitje, herë si rrugë e vëtrme përfitoren.

Tema e vëtmisë e parë edhe në plan social dhe ekzistencial do të jetë nga temat më të rëndësishme në vëllim, së bashku me mallin e trishtimin përfjetën që ikën pa u vënë re në kohën që ndryshon me dinamizëm.

Fazat e jetës të autorit merren në trajtesë në disa vjersha, sidomos me nostalji që bëhet shkas përfatë mbushur zemrën e poetit mërgimtar, formësohet faza e fëmijërisë dhe e rinisë, lidhur këto edhe me mallin përfatëshun që e shumëfishon nostaljinë përfatë kohën e ikur. Poeti është i vetëdijshëm përfatë filozofinë e jetës, që gjithçka në univers lind, zhvillohet e më pas i vjen fundi, vdes, prandaj e mbylli vjershën Dhimbje ndryshtë me këto vargje: "... oh pa sy, do ta pres pleqerinë". Me nota dhimbjeje përfshruhet një plagë e shoqërisë së sotme, dhunimi i femrës së cilës i janë kushtuar kryesisht dy vjersha Vajza që ece nëpër shi, Vajzës së kryeqytetit. Kryeqyteti gjithmonë ka nxitur poetët përfatë shkruar përfatë, pasi aty rritet më shpejt e keqja, veset, rrëmbimë pas parasë, shthurja e vlerave morale, vëtmia si një stimuluese e zvetënimit shpirtëror, sidomos të rinisë. Një nga këto figura është ajo e vajzës në të dyja poezitë e lartpërmendura. Ka edhe ndikime nga poezi populllore si: Malli me bahçen më ftoi.

Në poeinë e Arif Molliqit gjemjë edhe sensin ironik e satirik të vlerësimit të realitetit bashkëkohor lidhur me simbole të shumta që sjanë gjë tjetër veçse parallelizma figurative të nënkuptuara. Te poezi Një kostum evropian, Kam bërë një kapërcim, Loja me litar, Diqysh po më duket, Prova e një ore, Kryeqyteti i krimbane vihen në pah me tallje të fshehtë dukuri negative të jetës shoqërore dhe individuale. Përfatë sa iu përket mjeteve artistike të përdorura nga autori në vëllim, ato krijojnë në përfytyrimin e lexusit marrëdhënie të tillë ku koha reale shkruhet me kohën artistike dhe gjithçka përfjetohet sikur ndodh në çastin e shkrimit të poezi. Ndërriturja e planeve kohore të së kaluarës me të tashmen e të ardhmen, kriju kështu një kompozicion kohor të caktuar dhe është sigurisht vlerë e vëllimit. Si kripët të kam dashtë të autorit Arif Molliqi.

Ndryshimi i rendit kohor të ngjarjeve, veprimeve, ndjenjave, krijojnë situata të veçanta dhe lexuesi përfshihet nga një gjendje shpirtërore që e déshiron autori, përforcohet një ndjenjë, ndjesi, apo një përfytyrim në një moment të caktuar dhe kështu natyrshëm zbulohet thelbë i karaktereve, mesazhet. Vështrimi retrospektiv dhe ai i çastit i pasqyrimut të ngjarjeve janë kombinuar në mënyrë të atillë që i shërbijnë ngarkesës emocionale-shpirtërore të lexusit. Pra, mund të themi se ky krijues e përqendron më tepër vëmendjen në transmetimin e lëvizjeve, të dinamikave gjithfarështë të jetës, pa u kujdesur shumë përfatërit, rimën, përfatësosjen e formës. Nuk duhet lënë pa theksuar se janë ndjenjat ato që e përcaktojnë cilësinë e poeziës dhe ky vëllim shpalos ide dhe mesazhe, tema të begata vëtëm përmes ndjenjave. I urojmë autorit shpërthime të mëtejshme lirike, frymëzime të mirëfillta artistike, procese krijuimesh të larmishme që kurorëzojnë vepra artistike që burojnë nga shpirti. E vërteta e botës së brendshme shpirtërore të shkrimit, të ideve dhe vëçorive të shijes vetjake të tij, merr në vepër ngjyrë përgjithësimi që u shërbijnë kohëve.

## Qasje

# VDEKJA E NOSITIT, TRAGJEDI APO DRAMË POETIKE!

Lasgush Poradeci me "Vdekja e Nositit", na çon të mendojmë dhe na bën me dije se nuk është jetë ajo që thuhet para se të vdesim, por jetë është ajo kur kemi forcë ta durojmë vdekjen, të përballemi me të dhe të dalim fitimtarë dhe të mbijetojmë me të

### Sulejman MEHAZI

Vdekja është gjeja më e tmerësme nëse kështu kemi dëshirë ta pagëzojmë. Të përcaktohesh përfatë vdekjen është niveli më i lartë shpirtëror e artistik, që kërkon fuqi tejet të madhe, pasi dashuria pa fuqi shpirtërore urretet nga arsyja, sepse asaj i ngarkohet diçka që nuk mund ta durojë. Lasgush Poradeci me "Vdekja e Nositit", na çon të mendojmë dhe na bën me dije se nuk është jetë ajo që thuhet para se të vdesim, por jetë është ajo kur kemi forcë ta durojmë vdekjen, të përballemi me të dhe të dalim fitimtarë dhe të mbijetojmë me të. Kërkon dhe do të forcojë unë e tij poetik përfatë ta luftuar në çdo mënyrë të keqen. Këtë përkapje origjinale të përmasës poetike e shohim edhe si koncept të përsosjes dhe njohjes poetike, kjo njohje poetike shppreh pasqyrimin e vërvetes ndaj unit të tij artistik dhe nëpërmjet pelegrinazhit shpirtëror primordial tragjik, arrin shkallën e ndritjes poetike. E çfarë do të thotë kjo përfatë Lasgushin dhe ne si studiues dhe lexues të tij? Kjo do të thotë jetë shpirtërore e imaginatyive, dramatike e tragjike, artistike e poetike, jetë e hapjes së varrit në gji:

"Me zjarr ju flas..., me zjarr...  
Në gjirin t'im kam hapur varr"

Zjarri është shpirti i poetit, kur në këtë moment të frymëzimit digjet çdo gjë në mbrendinë e tij, kjo kriju dhembje të fuqishme, prej kësaj dhembje të fuqishme formohet flaka poetike, kjo flakë kriju në gjirin, gjoksin dhe zemrën e Nositit një varr të hapur, që e ka kuptimin e sakrificës poetike, idealitet dhe rrugës poetike të tij. Kjo sakrifice poetike, ky varr i mbrendshëm është shkak i "liquerit zemérak" që te "zemra" e Nositit "kullon gjak".

"Un' ik liquerit zemérak  
Fatlum dh'i pastër si zëmbak,  
Po zemra ime kullon gjak:"

Gjaku që kullon nga zemra e Nositit shdërrohenet në tragjedi apo dramë poetike, që përfatë poetin do të jetë përcjellëse e përhershme e rrugëtimit të tij poetik. Nositi duke qenë i pa aftë të tolerojë dhembjen, përballon kundërshtitë e vdekjes, pa asnjë, pa forcë fizike, por me zjarrin e gjuhës

poetike:

"Me zjarr ju flas..., me zjarr", me varrin në gji: "Në gjirin t'im kam hapur varr" dhe kullimin e gjakut në zemrën: "Po zemra ime kullon gjak", që e ka kuptimin e qetësisë poetike shpirtërore. Kjo fuqi nuk është diçka pozitive që stërvishet prej negatives, por kjo është fuqi që e shikon në sy negativen dhe është gati të banojë në të. Këtu nuk bëhet fjalë përfatë diskurse shterpe, por përfatë serioze, është kjo jetë e shpirtit që është gati të ballafaqohet me gjërat që janë të padurueshme.

Valët e ujit, gjenocidi, holokausti, despotizmi dhe fatalizmi, bille edhe ballafaqimi me këtë fuqi të shkatërrimit është obligim i të menduarit dhe autoterapia është në të vërtetën e vdekjes. Fuqia e shpirtit është në artin poetik si mikrokozmos, gjegjësish si botë e vogël, që përbën kurorën e makrokozmosit, dhe, si mikrokozmos apo si botë e vogël që përmban shpirt të çiltër nëpërmjet të cilës depërtion në rrugën e ndritur të artit dhe i përfjeton pasqyrimet e poeziës së frymëzuar.

Ky etos i çmendur i shpirtit dhe vlerat e përtypura të këtij etnosi çojnë drejtë një kataklizme eskatologjike të ekohapsirës shpirtërore, ndotja e shpirtit në faqet e natyrës makrokozmkie lë gjurmët e saj edhe në natyrën mokrokozmkie.

Si ka mundësi që shpirti të vuajë e trupi mos ta ndiejë këtë vuajtje. Pikërisht, Lasgush Poradeci me anë të kultivimit të ekologjisë shpirtërore i del përballë dhe i kundërvihet fuqisë intenzive dhe të fuqishme të së keqes, pasi ajo është "raison detrè" e fatkeqësisë ose mirëgenies, fascinimit ose mallkimit, jetës ose vdekjes, shpresës ose optimizmit.

1."Me zjarr ju flas... me zjarr"

Paralajmërim apo përkujtim, rikuqit artistik, që do të thotë mbrojtje e gjërvave të çmuara, është trajtë më e përsosur e veprimit të brendshëm, thelbë i brohoritjes dhe artit poetik dhe i pranishëm në gjithë sistemin poetik të L.Poradecit.

2."Un'ik liquerit zemérak"

Në aspektin poetik, pendim përgabimet e bëra, kthim prej mëkateve duke u penduar. Pendimi është trajtë më e çiltër e

kërkimit të faljes dhe ndjesës, pendim i singertë poetik që mund ta shpreh poetikisht vetëm Poradeci. Pendim vetëm me zemrë e gjak të pastër, kërkim i ndjesës me gjuhë të zjarrtë dhe vendosmëri me trup të mos bëhet më ai mëkat.

3. "Se vijnë-urtuar zoqtë e mi"

Në aspektin metaforik do me thënë, dashuri kuptimore, pastër i qetësi, lartësi dhe pasqyrim, lidhje apo përgjegjësi, thelbë i diçkaje, mbrojtje dhe rruajtje e dashurisë. Dashuri më e fortë, më e thellë, më e fuqishme dhe më e lartë.

4. "Pa nis ah! Gjirin ta godas"

Ekstazë, që do me thënë, gjetja e pjesës së humbur, hidhërim, dëshpërim, ankesë, helmim, pasuri potenciale, dashuri e tepër e kulminante.

5. "Ahëre-helmojet e buçet"

Zili poetike e liquerit të shkretë përfatë shkak flijim artistik.

6.."Ay e tund, ay e shkund"

Paraqet rrugën më të sigurtë të vajtjes së shpirtit në përsosuri.

7. "E shpirtin dyke m'a përcjellë  
Më thotë-ah shih sesa'sht' i fellë  
Ky gjir'i em që të pat pjellë..."

Me zjarr ju flas, me zjarr

Lasgushi shpreh një poetikë që njeriut ia mundëson përkujtimin e originës së tij artistike.

### VDEKJA E NOSITIT

Me zjarr ju flas..., me zjarr.  
Në gjirin t'im kam hapur varr...  
Që t'i jap shpresë-edhe t'ja marr...

Un'ik liquerit zemérak  
Fatlum dh'i pastër si zëmbak,  
Po zemra ime kullon gjak:

Se vijnë-urtuar zoqtë-e mi,  
Dh'u jap ushqim me dashuri-  
Një dashuri përlaftari:

Pa nis ah! gjirin t'a godas...  
Dh'e hap ahl-gjirin më një ças...  
Dh'i nganj ah! zoqtë-e vdes me gas...

Ahere - helmojet e buçet  
pas mallit t'im lijeri - i shkret,  
e rit tallazin posi det.

Ay e tund, ay e shkund,  
ay e hap sa me të mund,  
gjer mu në gjit, gjer mu në fund.  
E shpirtin dyke m'a përcjellë,  
më thotë-ah! Shif sesa'sht i fellë  
ky gjir'i em që të pat pjellë...  
...Me zjarr ju flas, me zjarr.

**MOHIME**

Besimi im i humbur  
është pronësi e jotja...  
Mua më mbetën në fyt  
ca çaste nga euforia...  
Tash luftoj më shumë  
e më pak zhgënjejhem  
me një motiv më pak  
nga dashuria...

**REBELIME**

Shtrihen vështrime  
tej dukjes e pa dukjes...  
Sytë e egërsuar -  
pasqyrë e kësaj bote...  
E keqja s'ka stimul  
as dekor...  
e nuk pranohet  
shëmtia e kësaj toke... !

**MASKARADE**

Humba kohë  
mbi origjinë fati...  
mësova kush e lind  
e kush e vret.  
Shoh si shpiken zota  
e kopilë zotash...  
maskarada e botës  
s'ka më sekret !

**BESTYTNI**

Mbi mbrëmje kthehet  
flliadi i parfumuar  
perëndimi vdes  
ndër krahë terri.  
Harkun e kësaj bote  
shumë e përshkuan...  
e askush  
s'rili ndërtim  
si dielli... !

**MBRESE**

Kërkoi të gjej  
një specie të çfarëdoshme  
lindur pafajësish  
në një strofull bosh...  
ta pyes ç'kujton  
nga dhimbja vendlindje  
kur të kthejë  
kokën pas..... !

**UNI PA EMER**

Tash... bërë zot i marrëzisë sime  
nga barbaria...  
Ndjej zérat n'arrisje  
me një copë quell të fyter  
si dëshmi origjine  
duke mbartur në memorie  
profecitë e rrreme !  
Kurova plagët  
me dogma tokësore e enigma hyjnore  
e shpejt... ra bota e èndrrave  
si perandoria romane.  
Veç britma në sordinë e sulme të fjetura  
e urrejtje ndaj legjioneve të mia  
të dorëzuara pa kushte...  
E zgjatet vazhda e epokave të pangopëshme -  
njeringrënëse rrugët  
njeringrënës qelli e deti  
e stinët mbuluar  
me polen frike !  
Prekma emrin  
si djeg  
mes tre kohëve të përcudshme...  
Nën rrathë mundimesh prej dielli e hënë  
tash, simulohen vajet  
në këngë epike...  
Ah ! Totalitare vuajtja, zemërimi e heshtja  
totalitar pushteti e koha e humbur  
anonim fati  
e vërteta e loti  
në rrugën pa kthim  
të unit të bjerrun... !

**NGJASIM**

Shi... ah shi  
mbi supet tona akoma të pa kërrusura...  
Shpesh stinët ndryshojn' fytyrat  
me reshje, stuhi  
deri në përmbytjen profane !  
E kotë, protesta jonë  
ndaj kësaj dhune të pa ndërgjegjshme,  
njëloj si në regjimet  
anti humane !

**EPILOG**

I pa qetësueshëm  
pështjellimi i ditëve  
i pa mbarueshëm  
shtegtimi i shpresave...  
Prapë ti nisesh  
nga ikja në ikje  
tu gjendesh pranë  
pritjeve të kahershme...  
E duke qepur  
gjurmët e arnuara  
tej rrugëve të reja  
hedh vështrimet  
Melodi të shurdhëta  
dertesh e èndrrash  
si liturgji asketësh  
ndërrojn' vend-banimet...

# KSENOMANI

Qazim SHEHU

Sapo e kisha botuar librin tim me tregime dhe po e kundroja me kujdes kopertinën, lidhjen, paraqitjen e tij estetike. Libri është si fëmija, thonë, por unë do të shtoja se kur vjen një libër, ai lind i rritur dhe nuk ka më mundësi të provojë veten, nuk do kujdes, sepse kujdesi ndaj tij i përket punës paraprake.

E mora librin tim dhe e dërgova në një librari. Para më dolni një vajzë e bukur, me një pamje disi të ndrojtur, por ndërsa komunikaja me të përmundësinë që ta reklamonte diku, ajo ma ktheu se nuk para ekte letërsia shqipe, veçmas librat me poezi, fare. Kishte kthyer mbrapsht sa e autorë dhe i vinte keq për këtë, por ishte e detyruar.

Nuk bëra zë, nuk doja ta zgjasja më këtë, vetëm tunda kokën dhe dola i heshur. Në trotuarin përballë librarisë, sytë me kapën një radhë librash shtrirë përtokë. Emra të mëdhenj: Dostoevski, Tolstoi, Balzaku, Kafka, Xhojsi, Man, Heminguej. Libra filozofikë, histori, monografi, rrinin shtrirë përtokë dhe kalimtarët kalon pa ua hedhur sytë.

Disa tituj më tregonin se i kisha lexuar, por seç kisha një têrheqje drejt tyre, pasi botimet ishin të reja dhe më ngjante sikur nuk i kisha lexuar. Ai që shiste ishte një i njohur, por u shmanga, bëra sikur nuk e pashë, sepse disa herë më kishte rekondituar libra të mirë dhe unë i kisha blerë. Ai e dinte që blija libra dhe në disa raste isha zënë ngushtë, se s'më ndodheshin paratë e mjaftueshme.

Bëra tutje dhe po mendoja: Në Tiranë ka lokale luksoze, po nuk ka librari

luksoze, ka dyqane mode, markete me hapësira të bollshme, por nuk gjendet që nuk gjendet një librari e përmasave të mëdha. Sikur të ishte një e tillë, ku autorët të çonin librat dhe njerëzit të shkonin, të lexonin, të blinin, të kontaktuan me autorët, të kishte lektorë të përgatitur dhe seriozë, sa mirë do që!

Ilodhur siç isha, hyra në një klub për të pirë diçka. Ndërsa kamarierja po vonohej, nxora librin tim të ri dhe po i gëzoresha. Mendoja se nuk ishte i keq. Por atij i rri përsipër një kopertinë e dyfishtë, mosnjohja dhe indiferencia. Edhe nëse e lexonte dikush, do të më lavdëronte për ato gjëra që edhe nuk duhen cekur, sepse çdo libër ka gjëra që nuk ritmojnë, këto i kupton autori, pas dy -tri vitesh, pasi ftohet pakëz.

E mora gotën e rakisë, më duhej një

gotë sa për një tonus ngazellyes, kur dëgjova një zë:

-Ej shkrimitar, ç'na ke shkruar?

Ngrita vështrimin nga libri dhe sytë më parë prokurorin EL, i ulur me dy shokë të tjerë, mbasë gjykatës apo avokatë. Nuk kishte rëndësi. Dikur ai is'ka qenë prokuror, por shoku im por, mbasi mbaroi kursin gjashtëmujor të Plepave, e ndoqi mirë karrierën gjyqësore dhe u bë një emër i dëgjuar i jurisprudencës, i shqiptuar për çështje të prekshme edhe nga media.

-Një libër me tregime, -thashë.

-Mund ta shoh?

U ngrita dhe ia dhashë librin. Ai e mori dhe çoc foli me shokët. Filloj ta shfletonte, tundi kokën. Kur u ktheva në tavolinën time, vura re një broke verë dhe një pjatë me dy bërxolla.



-I ke nga prokurori, - tha kamarierja.

Nuk bëra zë, as falenderova. Po shihja drejt tij. Pasi e shfletoi një copë here, ai ia dha librin njërit nga shokët që rrinte me të, siç dukej, vartës i tij, i cili ma solli në tavolinë.

-Megjithë qejf do ta blija, -tha, -por nuk lexoj letërsi shqiptare, lexoj letërsi të huaj, franceze, angleze, amerikane...

Mua sikur më ra tavani mbi kokë. Ky kokoroç, që s'e di se çfarë ka qenë, ende fliska si për pasnesë. Mendo sesi mund të formulojë ky idiot akuzat, si mund të japë pretencat, dhe aty për aty, falë intuitës sime të thekshme, ia ktheva:

-Ti ke të drejtë, -thashë, -shkrimitarët shqiptarë vuajnë nga mungesa e leximit...

-Atëherë përsë shkruani?...

-Këmbëngulim, për shkak të mungesës së leximit dhe besojmë se një ditë do të lexohemi...

-Ahali bëri ai me ironi dhe një shpërfillje, që u ndie nga intonimi...

-Por, -vijova, -përparrë se të përzëmë shkrimitarët shqiptarë nga ky vend, në fillim duhet të përzëmë prokurorët, gjyqtarët dhe avoketët shqiptarë; nuk do të ishte keq, - vijonte ironia ime sipas logjikës së tij - t'i zëvëndësonim me prokurorë italianë, belgë, francezë, anlezë. Jeta do të bëhej më e bukur pa prokurorët shqiptarë, sesa pa shkrimitarët shqiptarë. Sepse, sado të dobët të janë shkrimitarët shqiptarë, ata mundohen të ngrënë në kërmë të mirën, të bukurën, të cilën, siç është parë, ju e keni përdhosur...

U ngrita dhe dola pa ia prekur porosinë...

## SHPËRTHIMË...

Syhejl HAVOLLI

Dielli sikur ka vendosur ta pjekë qytetin tonë... Përparrë syve të mi kam lagjen e kuqe të qytetit tim: shtëpitë qëndrojnë të nemitura dhe nuk ia dalin që nuk ia dalin të ruajnë qoftë edhe vetëm disa palë grushtë qjritë të freskët për nën pullazet e tyre, të cilat, pothuaj deri më një, nuk e di nëse më shumë u përngjajnë luleve të diellit (Tërë lagjja e kuqe e qytetit tim - një arë e madhe e mbjellë me lule dielli...) apo kërpudhave pas shiut... Shtëpitë janë të heshtura..., pullazet e tyre digjen... Rrezet që thyhen nga kulmet, marrin udhën e qjellit në formë të qindra e qindra gjuhësh zjarri për t'u mbytur diku në kodrinat që e rrëthojnë nga lindja ose në tymrat që ngrihen andej nga perëndimi i qytetit tim, dhe hiri e pluhuri e gjithë gazet helmuese bredhur këtu mbi Kosovën tonë për të bërë dritë andej në viset e errëta të shtetit e të popullit drapër... E diel është, por këngë nuk dëgjoj..., nuk shoh asnjë flamur ngulur mbi shtëpitë...; në tërë lagjen time nuk bëhet asnjë dasmë (!? ... Sa çudi! As zëra fëmijësh nuk dëgjohen... A thua, ku janë fëmijët...?)

Vallë, ku janë djemtë dhe vashëzat që duhesin martuar tash në muajin e gushtit...? (Dhe më kujtohet një gusht, gushti i vitit një mijë nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë... Dhe më kujtohet një dasmë..., ka qenë dita e diel, po - po...) Djemtë kanë ikur..., kanë tretur me kujtimet e me dashuritë e tyre të para... Ata bredhin tashti nëpër kryeqendrat e Evropës a nëpër viset e shkreta e të ftohta të Skandinavisë... për një copë bukë..., grusht rrezesh dielli..., për një grimë rehatie... Dhe vashëzat shpalojnë kujtimet e tyre në oborre të zjarrita qytetesh e në ara përvëluese fshatrash... Ose vrapojnë pas dokumentesh... një pasaportë për të marrë udhën, kushedi, mbasë për të mos takuar kurrë më "princip e èndrrave"..., që mund të ketë gjetur prejte në përqafimin e ftohtë të një sykalstre ose brenda grilash të një nga burgjet e shumta anekënd kontinentit plak... Kushedi...

Zemra më qan... Sytë më mbushen lot... Dhembja më lidhet lëmsh në fyt

e më zë frymën... Kosova ka mbetur si çerdhet nga fundi i vjeshtës... O Zot! Fjalët e këngës "Atje është Prishtina... Atje është Rugova... Kosova ju thërrret... Kosova rënkon..." më therin shpirtin tim kaq të trazuar... Sa shpejt që hyri kjo këngë në shtëpitë tonë dhe sa shumë lavdërimë që ngjall... Egërsirës kanë zënë t'i dobësohen thonjtë..., kanë zënë t'i ligështohen kthethet... Nuk ka më forcë të vërvë perden e hekurt pr të penguar fjalën e fotografinë shqiptare që të depërtojë në Kosovë gjatë tërë ditës... Eh, egërsira..., bisha..., thonë që është më e rrezikshme para se të japë shpirt... Kushedi...

Sot në sofrën time u shtruan mysafirë fjala shqipe e fotografia, kënga e vallja shqiptare..., familja shqiptare e kisha e xhamia shqiptare nga Detroiti i largët atje tek humbet Dielli... Eh, populli im... Eh, fjalët e gjuhës së mirë...! Pleqtë që shikoj, në rrudhat e tyre sikur kanë ndryrë mallin e pashuar për vendlindjen, për mëmëdheun... dhe frikën se eshtrat e tyre do të kalben në dhe të huaj... Burrat e gratë, në fjalët që thonë, në shikimet e tyre të përmallshme, në buzëqeshjet... sikur i kanë të gdhendura vuajtjet e të afërmve, të prindërve, të atdheut të tyre... Fëmijët atje luajnë lojëra të tjera..., edhe qeshjet e tyre janë të tjera... Nuk janë qeshje mësuar nga vrapimi pas fluturash e nga bredhjet nëpër livadhe luleshumëngjyrëshe... As nga dashuria e singertë e gjyshit dhe e gjyshes... Ata qeshjet sikur i kanë mësuar nga filmi..., nga teatri... Sidoqoftë, fëmijët qeshin... Flamuri me shqiponjën e zezë në fushën e gjerë të kuqe valon e valon... Atë e mbajnë në duar... Kanë festë atje... të njëzet mijë shqiptarët... Kremtojnë përvjetorin e heroit kombëtar - Dedë Gjo Luli... Shqiptarët kremtojnë për ne, për veten atje larg... Ata brengosen për ne... Ata edhe këndojnë, edhe vallëzojnë... "Shqipëri, oj nëna ime, Ndonëse jam i mërguar..." thërrasin të gjithë njëzëri për ta përfunduar "Oj Kosovë, oj nana ime... Zemra ime kurrë s'ka me t'harruar..." Dhe sytë prapë më mbushen lot... Janë këta lot dhembjeje? Lot mallëngjimi? Lot krenarie? Këta janë lot..., lotët e mi për shqiptarët..., për Kosovën! Le të jenë lëng vaditës..., lëng freskimi për zemrat e zhuritura...!

# ARRATIA E FUNDIT E BABAIT



Bruno Schulz

Ndodhi në periudhën e vonë dhe të mjerueshme të përçarjes së plotë, në kohën e likuidimit të biznesit tonë. Tabela sipër shitore qe hequr, grilat ishin të lëshuara gjer në gjysmë, dhe brenda nëna ime i ishte përveshur tregtimiit në të zezë të gjithçkaje që kishte mbetur. Adela, shërbyesa jonë, kishte shkuar në Amerikë, dhe thuhej se barks me të cilën kishte lundruar qenqësh fundosur e të gjithë udhëtarët paskëshin humbur jetën. Një thashetheme të tillë nuk e verifikonim dot, por çdo gjurmë e vajzës qe zhdukur dhe nuk morëm më lajm prej saj.

Filloi një epokë e re – e zbrazët, esëll, e trishët, si një fletë e bardhë letre. Një shërbëtor e re, Genia, anemike, e zbehtë dhe e pakockë, ende poshtë e lart nëpër dhoma. Kur dikush e cekte pas shpine, ajo përpeltej, zgjatej si gjarpër ose gërvishjet si mace. Kishte një çehre të bardhë e të plogësht, madje edhe brendinë e qepallave e kishte të bardhë. Ishte aq e përhumbur sa ndonjëherë bënte salcë të bardhë prej lettrash e faturash të vjetra: ta shpifte e nuk shtihet në gojë.

Aso kohe, babai im ishte padyshim i vdekur. Ai po vdiste disa herë me radhë, gjithmonë me ca ngurrime që na nxisin në rishqyronim qëndrimin tonë kundrejt faktit të vdekjes së tij. Kjo kishte përparsështë e veta. Duke e copëzuar vdekjen e tij, Babai na kishte familjarizuar me largimet. Dalengadalë u bëmë mospërfillës ndaj rikthimeve të tij – secili më i shkurtër, secili më i përvajshëm. Tiparet tashmë i ishin shpërndarë nëpër gjithë dhomën ku kishte jetuar e po mbinin, duke krijuar kështu në disa vende nyje të quditshme njashmërie nga më shprehëset. Letra e murit filloj i imtojë dellin e tij shpërthyesh e të zakonshëm; dizajni i luleve u vetërregullua në format e trishta të buzëqeshjes së tij, simetrike porsi gjurmët e fossilizuar të një trilobiti. Për njëfarë kohe, u shmangëm palltos së tij të gëzoftë, punuar me lëkurë qelbësi. Palltoja merrte frymë. Lemeria e kafshëve të vockla e të qepura kokë më kokë e përskonte si një rrjedhë e pafuqishme dhe humbej në palosjet e gëzoftit. Po të vendosnim veshin mbi të, dëgjohej njëzëshmëria e gërhimës melodike të gjunjtë të kafshëve. Në këtë formë të lënuar, mes erës së dobët të qelbësit, vrasjes dhe çiftëzimeve brenda natës, babai im mund ta kishte shtyrë jetën për shumë vite. Por nuk e bëri dot.

Një ditë, Nëna u kthye nga qyteti me fytyrë të shqetësuar.

"Pa shiko, Jozef," tha ajo, "çfarë rastësie fatume. E kapa tek shkallët, duke u hedhur

lart e poshtë" – dhe e ngriti një shami që mbulonte diçka në një pjatë. E njoha menjëherë. Ngashmëria ishte e frikshme, ndonëse tanë ai ishte një gaforre ose një akrep i madh. Nëna dhe unë e pamë në sy: pavarësisht metamorfozës, ngashmëria ishte e jashtëzakonshme.

"A është gjallë?" pyeta.

"Sigurisht! Mezi po e mbaj," tha Nëna. "Mos ndoshta duhet ta vendos në dysheme?!"

E la pjatën poshtë, dhe, të përkulur mbi të, e vëzhguam nga afër. Kishte një zgavër mes këmbëve të shumta e të lakuara, të cilat mezi i lëvizte. Kanxhat dhe birthët e tij të ngritur dukeshin sikur po dëgjonin. E vendosa pjatën pjerrtas dhe Babai lëvizë drejt dyshemesë me kujdes dhe me njëfatë hezitim. Me të prekur sipërfaqen e sheshit poshtë tij, nisi të lëvizë papritur me të gjitha këmbët, ndërsa nyejt e fortë prej këmbënyjori lëshonin një zhurmë kërcitëse. Ia preva rrugën. Ai ngurroi, hetoi pengesën me birthët e tij, më pas ngriti kanxhat dhe u kthye mënjanë. E lamë t'ia mbante kah ishte nisur, atje ku nuk kishte mobilje për ta futur kokën. Duke vrapuar me hov të valëzuar nëpër këmbët e tij të shumta, iu afrua murit dhe, para se të arrinim ta ndalonim, vrapoi lehtësish përpjetë, duke mos u ndalur askund. Pata një të njëjtur kur m'u ngjall një krupe instiktive gjersë e shiko tek njigjite nëpër letrën e murit. Në ndërkokë, Babai arriti deri tek dollapi i épërm i kuzhinës, dhe ashtu i varur për një moment në skaj, testoi terrenin me kanxhat, për t'u zvarritur më pas kah brendësia e dollapit.

Ai po e zbulonte apartamentin rishtazi nga këndvështrimi i një gaforje; dukshëm, përkapte të gjitha objektet përmes shqisës së nuhatjes, sepse, megjithëse e vështrova me kujdes, nuk mund të shquaja tek ai asnjë organ shikimi. Dukej se i shayrtonte me kujdes objektet që i dilnin përpara, duke ndaluar e duke i ndjerë me birthët e tij, pastaj duke i rrethuar me kanxha, si për t'i provuar dhe për t'u njohur; pas një kohe, i la ato dhe vazhdoi vrapin, duke tërhequr nga pas barkun pakëtë ngritur nga dyshemeja. Në të njëjtën mënyrë veproi me copat e bukës dhe të mishit që ia hodhëm në dysheme, duke shpresuar që do t'i hante. Ai ua hodhi një së përciptazi dhe vrapoi tutje, duke mos kuptuar që ishin të ngrënhshme.

Duke parë këto shayrtime të vëmendshme të dhomës, mund të thuhej se ai po kërkonte diçka me kokëfortësi dhe në mënyrë të palodhshme. Herë pas here vraponte në një cep të kuzhinës, strukej nën një fuçi uji që pikonte dhe, me të arritur

pikat e grumbulluara të ujit mbi dysheme, dukej sikur po pinte.

Ndonjëherë zhdukej për ditë të téra. Sikur ia dilte shumë mirë pa ushqim, madje kjo nuk dukej se ndikon në gjallërinë e tij. Të kapluar nga ndjenja të përziera turpi dhe neverie, gjatë ditës e fshihnim frikët tonë të fshehtë se natën vonë, ai mund të na vizitonë në shrat. Por kjo nuk ndodhi kurrë, megjithëse gjatë ditës endej gjithandje mobiljeve. I pëlgente të qëndronte veçanërisht në hapësirat midis gardëroba dhe murit.

Nuk mund të mos merrnim në konsideratë disa manifestime të arsyesh, madje edhe një sens humorë. Për shembull, Babai nuk mungonte kurrë në dhomën e ngrënies, megjithëse pjesëmarrja e tij në të ishte krejt simboleke. Nëse dera e dhomës së ngrënies mbappej rastësish gjatë darkës dhe ai mbetej në dhomën tjetër, e gërvishë fundin e derës duke vrapuar lart e poshtë përgjatë çarjes, derisa ia hapnim. Me kalimin e kohës, u mësua se si të fuste kanxhat dhe këmbët e tij nën derë, dhe pas disa manovrave të zhërvellëta, më në fund ia doli të fuste rrëshqitazi trupin e tij nëpër të dhe drejt dhomës së ngrënies. Kjo dukej sikur i jepte kënaqësi. Më pas ai ndalej nën tavolinë, i shtrirë krejt qetësish, me barkun që i pulsonte pak. Se cili ishte kuptimi i këtyre pulsimeve ritmike, nuk mund ta dinim. Dukeshin të pahijshme dhe keqdashëse, por në të njëjtën kohë shprehënin një kënaqësi mjaft të pështirë dhe epshore. Qeni ynë, Nirnodi, i afrohej ngadalë dhe i pabindur. E nuhaste me kujdes, teshtinte dhe kthëhej indiferent, duke mos arritur në asnjë përfundim.

Në ndërkokë, demoralizimi në shtëpinë tonë po shtohej. Genia flinte tërë ditën, e trupi i saj i pakockë valëzohej gjatë frysëmarrjeve të thella. Gjenim shpesh në supë bobina pambuku që ajo i kishte hedhur me perimet, pa u menduar shumë. Shitorja jonë ishte e hapur gjatë gjithë kohës, ditë e natë. U zhvillua një shitje e vazhdueshme mes pazareve dhe diskutimeve të ndërlidhur. Sikur të mos mjaftonte e tëra kjo, Xha Çarls erdhë për të qëndruar.

Ishte quditërisht i dëshpëruar dhe i heshtur. Deklaroi me një pshërëtimë se pas përvjave të fundit fatkeqe, kishte vendosur të ndryshonte mënyrën e jetës së dhe t'i përkushtohej studimit të gjuhëve. Ai u mbyll, për të mos dalë më kurrë, në dhomën më të largët – nga e cila Genia kishte hequr të gjitha qilimat dhe perdet, meqë nuk e miratonte vizitorin tonë. Kohën e kaloi aty, duke lexuar listat e vjetra të çmimëve. U përpinq të shkelte Babanë egërsisht, disa herë me radhë. Duke klithur nga tmerri, i

thamë të ndalonte. Më pas, ai vetëm vuri buzën në gaz me ironi, ndërsa Babai, duke mos e kuptuar rrezikun që kishte kaluar, vazhdoi të sorollatet dhe vëzhgonte njollat e dyshemesë.

I shpejtë dhe i lëvizshëm për aq sa ishte në këmbë, babai im me krustacët e tjerë e kishte të përbashkët karakteristikën e të qenët krejtësisht i palëvizshëm kur shtrihet mbi kurrit. Ishte e trishtueshme dhe për të ardhur keq ta shihje atë duke lëvizur dëshpërimisht të gjitha gjymtyrët dhe duke u rrotulluar pafuqishëm rrëth boshtit të tij. Vështirë se mund ta detyronim veten të shikoni mekanizmin e dukshëm, pothuajse të paturpshëm të anatomisë së tij, të eksposuar plotësisht nën barkun e nyjëzuar e të zhveshur. Në momente të tilla, Xha Çarlsi mezi përmbahej për të mos e shtypur Babanë. Vrapuam për ta ndihmuar me njëfarë sendi që kishim më afër dorës, të cilin ai e kapi fort me kanxha, duke rifituar shpejt pozicionin e tij të zakonshëm; dhe përnjëherë nisi një vrapim zigzag të rrufeshëm, me shpejtësi të dyfishtë, sikur dëshironë të zhduk kujtimin e rënies së tij të neveritshme.

Më duhet ta detyroj veten të raportoj me përpikëri veprën e pabesueshme, nga e cila kujtesa ime zmbrapset edhe tanë. Edhe sot e kësaj dite nuk arrrij ta kuptoj se si ne u bëmë autorët e vetëdi shëm të këtij krimi. Një fatalitet i çuditshëm duhet të na ketë tërhequr drejt tij; sepse fati nuk i shmanget vetëdijes apo vullnetit, por i përpin ato në mekanizmin e tij, ashtu që ne të jemi në gjendje t'i pohojmë dhe pranojmë, si në një ekstazë hipnotike, gjërat që në rrëthana normale do na shtinin tmerrin.

Tronditur keq, e pyeta nënën time gjithë dëshpërim, përsëri dhe përsëri: "Si mundë ta bëje këtë? Po ta bënte Genia – por ti vëtë?" Nëna qau, shtrëngoi duart dhe nuk gjeti dot përgjigje. A kishte menduar ajo se Babai do të shpëtonte ashtu? A kishte parë ajo në atë veprim të vetmen zgjidhje për një situatë të pashpresë, apo e bëri atë nga moskokëçarja dhe mendjelehtësia e pakonceptueshme? Fati ka një mijë marifete kur vendos të na imponojë tekat e tij të pakuptueshme. Mjafton një ikje e përkohshme e mendjes, një moment pavërmendjeje ose verbërie për të futur dhëlpërisht një akt midis Shillas dhe Karibdasit të të vendosurit. Më pas, me mend pas kuvendit, ne mund ta përsiatim pafundësish atë akt, të shpjegojmë motivet tona, të përpinqemi të zbulojmë qëllimet tona të vërteta; por akti mbetet i pakthyeshmë.

Kur Babai u soll mbi një pjatë, ne u përmendëm dhe e kuptuam fare mirë atë që kishte ngjarë. Ai shtrihet i fryrë dhe i enjtur nga zierja, me çehre të hirtë dhe i mpiksur. U ulëm në heshtje, të shtangur. Vetëm Xha Çarlsi e ngriti pirunin drejt pjatës, por menjëherë e uli poshtë krejt i pasigurt, duke na parë me mëri. Nëna urdhëroi ta conin në dhomën e pritjes. Më pas, qëndroi aty mbi një tavolinë të mbuluar me një pëlhurë kadijeje, pranë albumit të fotografive familjare dhe një kuti cigaresh. I lënë mëjanë, thjesht po qëndronte aty.

Por bërdhjeve tokësore të babait tim ende nuk u kishte pas ardhur fundi, ndërsa arratia e rradhës – zgjatja e tregimit përtjerë kufijve të lejuar – është më e dhimbshme. Përsë nuk u dorëzua, përsë nuk e pranoi se ishte i rrahir kur kishte qdo arsyë për ta bëre këtë, madje kur edhe vetë fati nuk e matuofste dot më shumë? Pas disa javësh palëvizshëmërie në dhomën e pritjes, arriti disi të përmblidhet dhe dukej sikur po shërohej dalengadalë. Një mëngjes, pjatët e gjetëm bosh. Njëra këmbë shtrihet në buzë të gjellës, në një salcë të ngjeshur domatesh dhe xhelatine që ia shtroi shtigjet e arratisë së tij. Ndonëse i zier dhe me këmbë që përskojen gjatë rrugës, ai e kishte tërhequr veten diku zvarrë me fuqinë e mbetur, për të filluar një bërdhje të pastrehë, dhe ne nuk e parë më kurrë.

(Nga anglishtja: Dhurata Alija)

## *Shkrimtarë për fëmijë: Bardhyl Xhami*

# DET I DHE RRËFENJA

**Kontributet dhe arritjet letrare të autorit Bardhyl Xhamë shpërfaqen veçanërisht në dy rrafshe: në zhanrin fantastike-shkencor dhe në zhanrin e rrëfenjës**

**Xhahid BUSHATI**

Bardhyl Xama (1933-2022) ka botuar veprat: "Pérrallat e detit", pérralla, 1975; "Zhytësit e vegjël të thellësive", novelë, 1977; "Ekspedita e kaltër", roman fantastike-shkencor, 1980; "Zjarrëfiks i pyllit", pérralla, 1987; "Terfili me katër fletë", novelë e pérralla, 1989; ribotim, 1999; "Pse quau delfini?", 50 rrëfenza, 1996; "Në kthethrat e piratit", roman, 1997; "Lejleku me akullore", 20 pérralla, 1998; "Djaloshi që kapte rrufetë", 60 rrëfenza, 2000; "Djali me tre brirë, pérralla, 2002; "Tre vëllezërit", novelë, 2003; "Arratisje nga kafazi", pérralla e rrëfenza, 2007; "Pëllumbi me fjongo të kuqe", 60 rrëfenza për fëmijë e prindër, 2007, Shtëpia pa libra si trupi pa shpirt, 32 rrëfenza, 2012, etj.

Përmendja e veprave të mësipërme flet pér një kontribut të vlefshëm dhe që ka lénë shenjë në fushën e letërsisë pér fëmijë. Shkrimtari Dritëro Agolli bën një cilësim të tillë: "... Bardhyli ka dhënë një kontribut të shquar në lëmin e letërsisë pér fëmijë, që nga libri i parë "Përrallat e detit" e deri te "Djali me tre brirë" i vitit 2002. Me këto ka luajtur një rol të rëndësishëm në ndezjen e fantazisë së fëmijëve pér animizmin e sendeve, që t'i bëjnë sendet e kafshët të flasin si njerëz, të nxjerrë në dukje aksionin, që u pëlqen tepér fëmijëve. "Përrallat e detit" kanë lindur... edhe nga eksperiencia e tij, sepse ka qenë zhytës i shkëlderuar e notar shumë i mirë dhe jo vetëm se ka lindur e është rritura në bregdet, por është vetë person i tillë. Se ka njerëz që lindin në bregdet, por mbyten në një legen me ujë." Gjithashtu na duket me interes edhe ky mendim i shprehur pér librin "Përrallat e detit", ku thuhet: "Teksa ribotohej vëllimi me përralla "Përrallat e detit"... nga Shtëpia Botuese Extra, pas gati tridhjetë vjetësh, lexuesit e moshës që kishin shijuar stilin e shkrimtarit patën mundësinë të transmetojnë atë stil dhe ato vlera edhe tek brezi tjetër. Fundja një letërsi e shëndoshë këtë kërkon, interesimin dhe ribotimin. Dhe "Përrallat e detit" kështu morë udhë-jetën e re të shkrimtarit që takonte lexuesit e tij në kohë, hapësirë e dimension tjetër lëvizjesh."

Duke iu rikthyer biografisë artistike të shkrimtarit Bardhyl Xhamë, mendojmë që kontributet dhe arritet e tij letrare shpërfaqen veçanërisht në dy rrafshet: në zhanrin fantastike-shkencor e në zhanrin e rrëfënjës. Le t'i themi dhe çà fjalë për zhanrin e parë, më shumë në aspektin e këtij zhanri duke parë prioritet e lëvrimit të krijuesve drejt kësaj letërsie. Me të drejtë studiuvesi Astrit Bishqemi, duke marrë si bazë përbajtjen e krijimit artistik-shkencor, qëllimet e tij, shkallën e fantazisë, etj., bëjnë dy ndarje të këtij zhanri: a) degëzimi njohës-shkencor dhe b) degëzimi fantastike-shkencor. Duke qenë njohës i krijimtarisë së Bardhyl Xhamës, vërej se, dukuria e tij më e shumtë është drejt degëzimit të parë. E dyta zë më pak hapësirë. Assesi nuk është mangësi; kjo është e lidhur me parapëlqimet vetjake të shkrimtarit, me komunikimin artistike-shkencor të tij me lexuesit e vegjël. re. Ajo, ("Ekspedita e kaltër" – nënvizimi im Xh. B.) kërkesat e artit i shkru natyrshëm me informacionin shkencor. Subjekti është interesant e tërheqës, ku veprojnë një numër personazhesh të realizuar artistikisht dhe bartës konfliktesh të shumëlojshme. Asokohe vepra solli kërshtëri e interes tek lexuesit e vegjël. Romani përmendet jo vetëm si arritte e autorit, por edhe si arritte e vetë zhanrit në letërsinë shqipe përfëmijë. Duke mos harruar se, është koha, kur ky zhanër ka një rrugë e përvojë modeste, endet përmes një kohe të politizuara e disa veprave tejet të politizuara e skematike, siç e përmenda më lart. Me këtë vepër dhe me guximin e tij krijues, shkrimtarji Bardhyl Xhamë çel një udhë të re shikimi në zbulimin e mistereve të detit, sjellë informacion të ri e të panjohur shkencor (të botës nenujore); njëkohësisht plotëson dhe zgjeron më tej larminë në individualitetet krijuese që

Në vitet '80, shkrimitari Bardhyl Xhami boton veprën "Ekspedita e kaltër". Një roman fantastiko-shkencor. Nuk ishte rastësi dhe as e papritur. "Shenjat" e para autori i kishte dhënë që me novelën "Zhytësit e vegjël të thellësive". Roman "Ekspedita e kaltër" (lëvron për herë të parë këtë gjini) plotëson më tej portretin shkrimtarit dhe është një mbarësi për të në sprovën e tij në këtë gjini të rëndësishme. Duke qenë një zhanër të ri në fushën e letërsisë përfshirë fëmijët dhe të rinj, dhe për vetë letërsinë ishte një zhvillim i ri, romani "Ekspedita e kaltër" theu disa tabu e klishe që mbartte politizimi i asaj kohe në lidhje me problematikat që trajtonte. Autori i shmangu me mjeshtëri. Vepra fitoi vlera se autori e njihët mirë detin dhe botën nënui-

The background of the poster is a detailed illustration of an underwater environment. A large, multi-colored fish with a yellow head and brown body is the central figure, swimming upwards. To its right, a long, slender eel-like snake with a patterned body and a yellow-tipped tail swims horizontally. In the bottom left corner, a white octopus with tentacles extended is partially visible. The ocean floor is covered with a variety of colorful coral reefs, sea anemones, and small tropical fish. The water is depicted with light rays filtering down from above, creating a bright and airy atmosphere.

të veçantë, jo e përsëritur nga autorë të tjera. Ngjarjet vendosen dhe zhvillohen në një të ardhme. Ka një përcaktueshmëri viti dhe kohe. Është fjala për një marrëdhënietë kësaj date me autorin, edhe pse me largësi kohe, autori sikur vë veten në provë në realizimin e "ëndrrave" të tij, për atë çfarë dëshmon në këtë roman. Ka meritën, siç thotë shkrimtari Thanas Qerama, se "... arrin t'i mbajë në një lidhje të shëndoshë ngjarjet e së ardhmes me ato të sotme, me traditën në përgjithësi, duke nënvízuar idenë se e ardhmja do të jetë vazhdim i të sotmes". Ngjarjet e kësaj vepre lidhen me një grup fémijesh, të cilët udhëhiqen nga inxhinier Gëzim Shkëmbi, profesor i shkencave hidraulike. Realja dhe fanta-shkenca janë në funksion të ndërtimit të maketit të hidro-centralit. Dhe për të realizuar këtë maket nis udhëtimi-studimor i quajtur "Ekspedita e kaltër".

Dukuritë e ndryshme shkencore që përshkruhen në raport me detin kanë një lidhje jo të zakontë me autorin. Kjo është e lidhur edhe me një veçori, i cili i zë vendi dukshëm në autobiografinë e tij: "Hobi i tij i veçantë, që e ka shoqëruar tërë jetën, ka qenë peshkimi dhe noti. Ai është zhytur në thellësinë e shumë deteve të kontinenteve të botës. Kjo i ka dhuruar atij mundësi e ndjesi për të njojur të fshehat e detit, të cilat i ka sintetizuar në shumë veprat e tij artistike për detin, aq sa kritika letrare, Bardhylin e ka quajtur "Shkrimitari i detit". Deti për të i ngjan një dielli, që nuk njeh perëndim. Janë të shtrenjta dhe Fterra, vendlindjen e shtrenjtë të autorit dhe Sarandën e tij të dashur janë emblema e kësaj dashurie

Symbolika e detit, ku më shumë e ku më pak  
është e pranishme në gjithë krijimtarinë e  
tij, sepse është pjesë e identitetit të tij, është  
vetvetja, ku i shëtit shpirti dhe i rreh zemra.  
Deti për autorin është metaforë fëmijërie,  
metaforë ëndrrë, metaforë dashurie, meta-  
forë e kthimit në vendlindje. Kjo metaforë  
me emrin det, që në faqet e romanit na  
paraqitet si një mrekulli më vete, mbart një  
anije, ku fëmijët hipur mbi të ndërmarrin  
një udhëtim studimor. Sipas studiuesit Astrit  
Bishqemi: "personazhet-fëmijë bëhen ri  
zbulues të dukurive të detit." Kjo  
marrëdhënie, në roman, zë një vend të  
dukshëm. Do të thosha se, këto janë skenat  
më të bukura, më magjepsëse, më  
mahnitëse, më poetike, sa reale aq dhe  
fantastike, që vetëm Bardhyl Xhami i njeh  
në shpirt, dhe me talentin e tij prej prozatori  
i piktuori si një artist i vërtetë; gjë që veprës i  
dhanë vlera të veçanta, një poetikë të  
papërsërishme, e cila të bën edhe sot ta  
lexosh me një kënaqësi dhe vëmendje të  
veçantë. Dhe, mbapse nuk mund t'i harrojmë  
dhe duhet t'i rikujojmë: enigmën e kaltëris-  
sisë së detit, lumenjtë pa brigje që rrjedhin  
në detin Adriatik dhe detin Jon, forcën e  
dallgëve, konfiguracionet e tabanit të detit,  
mineralet e tretura në ujë, etj., etj. Mendoj që,  
shkrimet kritike që janë marrë me analizën  
e kësaj vepre, në këtë rrafsh duhej ta përgen-  
dronin optikën e vështrimit studimor dhe  
vlerësues, si një vepër që edhe sot nuk e ka  
humbur aktualitetin. Gjithashu mendojmë  
se, nga ripunimi i herë pas hershëm që  
autori i ka bërë veprës së tij, ka eliminuar  
edhe disa disproporcione që janë vënë re në  
ndërtimi kompozicionel të romanit.

Teksa "shikoja" me ëndje këto piktura mbresëlënëse të skenave të romanit, m'u kujtua një shkrim nga shkrimitari Andrea Morua. Ai në mes të tjerave thoshte: "Tani që po shkruaj këto radhë, jam 78 vjeç dhe shpresat për një të ardhme të largët s'janë pér mua. Por ja që kemi një dëshirë të pashuar të mendojmë pér të ardhmen dhe ta përgatishim këtë të ardhme." Dhe këtu duhet t'i kërkojmë arsyet, pse autor i Bardhyl Xama, i vendosi dhe i trajtoi në një të ardhme, ngjarjet e romanit të tij "Ekspedita e kaltër". Dhe për një çast, le të takohemi me ngjarjet që flasin pér ardhmérinë e romanit. Kështu, Saranda, ku nisin ngjarjet e kësaj vepre, tashmë është bërë me të vërtetë një qytet me pallate shumëkatëshe e vila në gjithë kodrat, me Universitet, me hotele turistike, me portin e veçante të jahteve, etj. Bregdeti i Jonit dhe Adriatikut, që nga Butrinti deri në Durrës, është mbushur me hotele turistike e vila moderne, në Ksamil, Kakome, Bunec, Qeparo, Jal, Himarë, Dhërmi, Orikum, Pojan e me tej, janë ndërtuar e po ndërtohen qyteza e fshatra turistikë, ka gjetur rrugëzgjidhje "autostrada" në gjithë vijën bregdetare, deri në kufirin grek. Qendra turistike në Llogora dhe Orikumi, janë bërë të lakmueshme pér vizitorët vendas e të huaj. Butrinti, që pëershruhet si një qendër muzeore botërore, ku organizohet dhe një simpozium shkençor i përvitshëm, sot i ka tejkaluar parashikimet e autorit. Dhe kështu mund të përmendnim dhe sa e sa parashikime fantastike e shkençore që pëershruhen në roman e që sot kanë gjetur zbatim. Kjo ia shton vlerën romanit dhe kam bindje se do t'u nxitë fëmijëve e të rinjve të sotëm fantazinë dhe dëshirën pér të kërkuar eksperimentuar, pér të zbuluar e ndërtuar vepra të reja pér të ardhmen e vendit. Është një roman që gjithmonë ruan pamje të re me një vazhdimësi kohore. Shumë nga parashikimet fantastike që autor i ka parashtruar me imagjinatë që në vitin 1980, sot janë bërë realitet e disa janë vënë në rrugën e zgjidhjes. Kështu, duke u pozicionuar nga një lexim i sotëm, do të kuptojnë pse kjo vepër nuk i ka humbur vlerat e saj dhe bashkëkohësinë. Dhe kjo nuk është pak, është meritë e autorit.

# ARTI I RRUGËS

Argjentinë, Peru, Brazil dhe Shtetet e Bashkuara. Në Meksikë, teknika murale u njoh si arti zyrtar i revolucionit, si dëshmi e suksesit dhe rëndësisë së kësaj lëvizjeje



Nermin SHURDHA

Duke ecur rrugëve periferike të qytetit dalloni që ka mjaft hapësira të braktisura. Mbi të gjitha, ato janë struktura të vjetra që nuk përdoren më nga njëzet e janë lënë aty: të braktisura. Duke parë këto ndërtesa të rrënuara ose mure gri, një rjeri si unë do të donte të shihte pak ngjyra. Murale që mund t'u japid një shans të ri këtyre zonave tashmë të braktisura..

#### ORIGJINA E MURALEVE

Murali është një pikturë e realizuar në një mur, një tavanc ose thjesht një sipërfaqe të madhe të përhershme në murature. Prej këtij vjen fjala murales, në spanjisht mural dhe në shumë murales.

Terimi përdoret gjithashtu për të identifikuar zhantin e pikturës që u bë i famshëm për lëvizjen meksikane të quajtur muralismo. Muralizmi është një lëvizje pikture që lindi në Meksikë pas

revolucionit historik meksikan të vitit 1910.

Artistët e vendit, si Diego Rivera (bashkëshorti i Frida Kahlo-s), José Clemente Orozco dhe David Alfaro Siqueiros, braktisën teknikat tradicionale të pikturës dhe mjetet konvencionale si kavaletat dhe bojërat e vajit, për të filluar përdorimin e pigmenteve të reja me ngjyra të njohura me termin Akrilik.

Veprat u realizuan në mure të mëdha të destinuara për popullin, ku u pikturuan luftat e klasave, aspektet e historisë popullore dhe ndjenjat nacionaliste. Piktura murale gjithashtu u zhvillua dhe u përsos në fushën e ndërtesave publike dhe arkitekturës qeveritare.

Rreth vitit 1930 muralizmu u bë një lëvizje ndërkombëtare, duke u zhvilluar gjithashtu në Argjentinë, Peru, Brazil dhe Shtetet e Bashkuara. Në Meksikë, teknika murale u njoh si arti zyrtar i revolucionit, si dëshmi e suksesit dhe rëndësisë së kësaj lëvizjeje. Në fakt, subjektet e muraleve



shpesh mund të janë paraqitje alegorike të fryshtuara nga motive dhe ideale politike.

#### MURALET DHE GRAFFITI

Muralet nuk duhet të ngatërohen me Graffitet (mbishkrimet). Këto të fundit, siç sugjeron edhe vetë termi, burojnë nga shkrime kryesish në formën e firmës/nënshkrimit të skicuar fillimisht, të cilat zhvillohen më pas duke u zmadhuar dhe paraqitur në realizime të ndryshme.

Nuk ka datë në të cilin kalindur graffiti, është pak sikur të kishte ekzistuar gjithmonë. Dëshmi për këtë është fakti se Koloseu është i mbuluar me shkrime të lëna nga njëzet të panjohur ndër shekuj.

Në vitet '60, shfaqja e bomboles spray të aerosolit u ofroi të rinjve të vitezë '70 dhe '80 një mjet veçanërisht efektiv për të lënë mbishkrime në muret e qytetit. Prandaj ishte spray ai që i dha shtysë lëvizjes Graffiti, e dominuar nga kultura hip-hop në Amerikë dhe kultura punk-rock në Evropë.

#### MURALET DHE ARTI I RRUGËS

Aktualisht krashtimi dhe përshkrimet e ndryshme bëhen gjithmonë mes Artit të Rrugës dhe Grafittit, pa përmendur asnjëherë emrin Murales.

Përkufizimi i Artit të Rrugës shprehet

kështu në Wikipedia: "Ato forma të artit që manifestohen në vende publike, shpesh në mënyrë të paligjshme (pa leje të qartë), në teknikat më të ndryshme: bombola spray, ngjitése artistike, art normografik, videoprojeksione, skulptura, etj."

Pra, a mund të përfshijmë edhe Muralet në Artin e Rrugës?

Muralet - janë teknika më e përdorur në fushën e artistëve të rrugës; të pajisura me penela, ngjyra, spatula dhe teknika të ndryshme të shpikura për momentin, artistët pikturojnë piktura të vërteta moderne ndonjëherë me përmasa vërtet befasuese, por jo në pëlhurë pambugu sic jemi mësuar të mendojmë, por në mure, ndërtues apo gjithçka që është pjesë e arredimit urban.

Për të qenë në gjendje të punojnë në lartësi të mëdha, këto artistët shpesh duhet të pajisen me skela, kova ose shufra teleskopike që të mund të punojnë në siguri të plotë në sipërfaqe të mëdha. Vetëkuptohet se për krijimin e veprave monumentale në shkallë të gjerë, kërkohet aftësi artistike dhe një ndjenjë proporcionale i nivelit më të lartë.

Disa nga këto vepra janë realizuar me një teknikë shumë të afërt me teknikën trompe l'oeil dhe përfaqësojnë kryevepra të vërteta të artit. Shumë murale të cilat fillimisht duhej të ishin thjesht jashtë normës, janë bërë të farnshme dhe të tjera kanë pasur edhe funksionin e rizhvillimit urban të zonave të degraduara.

# BOOM-i LATINOAMERIKAN

**Realizmi Magjik** është një rrymë artistike që paraqet elemente magjikë apo situata alogjike, krahasuar me vepra të tjera letrare të konsideruara më realiste apo më normale

Bajram KARABOLLI

Letërsia latinoamerikane është një kontinent më vete. Natyrisht, në relievin e këtij kontinenti ka male, vargmale, kodra e lugina, ashtu siç ka edhe hapësira të shkreta. Unë besoj se kështu janë të gjitha kontinentet letrare. Por janë pikërisht shkrimitarët latinoamerikanë të gjysmës së dytë të shek. XX, si Luis Borges (Luis Jorge Borges - Argjentinë), Aleho Karpentier (Alejo Carpentier - Kubë), Migel Anhel Asturias (Miguel Ángel Asturias - Guatimalë), Juan Rulfo (Juan Rulfo - Meksikë), Karlos Fuentes (Carlos Fuentes - Meksikë), Hulio Kortasari (Julio Cortázar - Argjentinë), Gabriel Garsia Márquez (Gabriel García Márquez - Kolumbi), Mario Vargas Josa (Mario Vargas Llosa - Peru), Hose Donoso (José Donoso - Kili), Álvaro Mutis (Kolumbi), etj, të cilët përbëjnë atë plejadë të mrekullueshme që krijoj këtë rrymë letrare të pashoqe, rrymë që bëri epokë dhe hyri në historinë e letërsisë botërore me emrin "Realizmi Magjik". Janë pikërisht këta shkrimitarë latinoamerikanë, magjikorrealistë, të cilët shpërthyen - mendoj se në këtë rast shërben kjo fjalë - atë që quhet "boom" i atyre viteve. Pra, është një rrymë arti që u zhvillua në gjysmën e shek. XX dhe që u shpreh, kryesisht, përmes letërsisë, por, herë-herë, edhe përmes piktures apo kinematografisë.

Realizmi Magjik është një rrymë artistike që paraqet elemente magjikë apo situata alogjike, krahasuar me vepra të tjera letrare të konsideruara më realiste apo më normale. Është një strategji letrare, ku shqetësimi dhe interesi stilistik është që ta paraqitë të zakonshmen dhe të përditshmen si diçka areale dhe të habitshme. Është një lloj fiksioni i kultivuar kryesisht nga shkrimitarët iberoamerikanë. Realizmi magjik ishte përgjigjja ideale për autorët, të cilët, duke jetuar në vendet ku diktatura dhe censura korruptoin të gjitha ambientet e shoqërisë, mundën të shpreheshin, duke lejuar, përmes fantazisë, të shpjegonin elemente të realitetit, pa u ekspozuar ndaj censurës, ose duke qenë në mërgim.

Termi "realizëm magjik", për herë të parë që përdorur në vitin 1925 nga kritiku gjerman Franz Roh, i cili, me këtë term i referohet një stil të veçantë në pikture, ose më saktë rrymës ekspressioniste të këtij arti ku, sipas tij, sfondi realist i një pikture përmبante edhe elemente fantastikë dhe irealistë. Më vonë, ky term u përdor për të karakterizuar stilin e disa piktorëve amerikanëve si Paul Cadmus, Ivan Albright dhe Georg Tooker, midis artistëve të tjera të dekadave 1940 dhe 1950. Veç, nëse në artet vizuale ky term i referohet një vepre me elemente realiste ekstremë, në letërsi, përkundrazi, i referohet një vepre me elemente magjikë dhe alogjikë.

I pari që e përdori termin "realizëm magjik" në kritikën letrare, duke emëruar kësijoq një stil të pasur letrar latinoamerikan, që studiuoi dhe kritiku portorikan Anhel Flores (Angel Flores). Më vonë pati edhe ndonjë studiu që, veç shkrimitarëve iberoamerikanë, përfshiu në këtë rrymë letrare edhe ndonjë shkrimitar nga kontinenti të tjere si Günter Grass, Milan Kundera, apo Salman Rushdie.

Realizmi Magjik është një rrymë letrare që ka precedencë, duke nisur qysh nga shek. XVI me stilin letrar barok, më pas me romanin gotik të shek.



XVIII, por edhe më vonë në shek. XX, me lëvizjen surrealiste. Gjithsesi, dalëngadalë, realizmi magjik zuri vend në vetëdijen letrare botërore si një rrymë avangarde e viteve '50 - '70 të shek. XX, me atdhe Amerikën Latine. Shkaku pse u zhvillua dhe lulëzoi pikërisht në këtë kontinent dhe në këtë periudhë, sipas shumë studiuesve, ishte mospajtimi midis kulturës së teknologjisë dhe kulturës së supersticionit, po ashtu, siç u tha më lart, edhe periudha e lulëzimit të diktaturave politike në këto vende që, me ushtrimin e censurës, e ktheu fjalën në një mjet tejet të çmuar dhe të manipulueshmë.

Kritikët letrarë kanë përdorur fjalën "magjik" për të emërtuar një prirje të caktuar në novelistikën e shek. XX, e cila karakterizohet nga nderimi për mitet dhe përdorimin e tyre brenda një konteksti realist. Jo pak studiues përfshijnë aty edhe të mbinatyrrshmet, mitket dhe besimet popullore. Nuk bëhet fjalë për ta "paraqitur magjinë sikur të ishte reale", por për të paraqitur "realitetin sikur të ishte magjik". Kemi të bëjmë me një fokusim të së mbinatyrrshmes. Pra, është një lloj fiksioni i kultivuar, kryesisht, nga romancierët iberoamerikanë, gjatë gjysmës së dytë të shek. XX. Realizmi Magjik, ashtu si edhe pjesa e madhe e letërsisë së kësaj periudhe, pa dyshim që, thelbësisht, është një rrymë letrare e moderuar. Në veprat e shkrimitarëve magjiko-realiste krijuhet një botë ku fantastika dhe magjikja bashkekzistojnë me realen, sikur të kishin lindur nga e njëjtë brendi e gjëra. Veç kjo rrymë letrare e paraqet realitetin narrativ të përzier me elemente fantastikë dhe përrallorë, jo aq për ta stolisur atë sesa për të zmadhuar kontradiktën e tij të brendshme.

Prozatorët latinoamerikanë të realizmit magjik, në krijimet e tyre narrative, brenda vëtë natyrës, krijojnë

një klimë të mbinatyrrshme. Duke e deformuar realitetin, ata i bëjnë personazhet dhe ngjarjet më të dallueshme. Në këto trille të fuqishme personazhet nuk hutohen përparrë të mbinatyrrshmes, e pranojnë atë si një pamje tjetër, një pamje më shumë, të realitetit, duke provokuar kështu tek lexuesi ndjenjën e habisë. Kështu, për shembull, tek tregimi "Axolotli" i Hulio Kortasarit, personazhi rrëfimtar, në mënyrë fatale, pranon të kthehet në amfib (peshk); ose tek tregimi Çak Mol i Karlos Fuentes, autori, metaforikisht, përdor perëndinë maja të shiut, si simbol të së kaluarës për tia kundërvënë stilist të jetës së Meksikës moderne. Vdekja e Filibertos, shpërthimi i uit me njëjë të kuqe apo makijazhi i Çak Molit janë disa nga këto metafora dhe simbole që flasin fuqishëm kundër meksikanëve modernë. Është një tregim që rreh të njëjallë vetëdijen mbi të kaluarën e "humbur", një çështje që i përket Meksikës.

Për sa i përket karakteristikave të realizmit magjik, studiues të ndryshëm i kanë përcaktuar ato në numër dhe forma të ndryshme. Por, edhe pse mund të jenë hartuar në formë të ndryshme, përbajtjet e këtyre karakteristikave përkijnë, duke vënë në dukje të njëjtat gjëra. Disa tekste të historisë së letërsisë apo disa lektorë universitetesh, ngaqë kanë të bëjnë me një masë të madhe lexuesish, i kanë formuluar ato më saktë dhe më qartë. Sipas tyre karakteristikat kryesore të realizmit magjik janë këto:

1. Shkrirja e reales me fantastiken: Mund të jetë një kontekst fantastik me personazhe realë, ose një kontekst real me personazhe fantastikë.
2. Ëndërrimi: Protagonistët e intrigës zakonisht shpesh shtullohen dhe veprojnë në terren ëndërrimi. Rrëfimet shumë herë, nisin në ëndrra që shohin personazhet apo edhe vëtë historitë zhvillohen në terrenin e ëndrrave, si

skenar që tregimi të bëhet më tèrheqës.

3. Realizmi: Karakteristikë e realizmit magjik është edhe marrja nga realizmi një shprehje transparente dhe konkrete e gjuhës, me qëllim që të bëjë përshtime të holla ku, midis të tjerash, ka elemente të zakonshme dhe të njohura, ndjenja familjare, apo të dhëna historike.

4. Fantazia e vlerësuar si diçka reale: Elementet magjikë në një vepër të realizmit magjik vlerësohen si normalë prej personazheve. Personazhet për një çast e pranojnë fantastiken si reale.

5. Përdorimi i të tri vetave: Në tregimet e realizmit magjik latinoamerikan mund të rrëfehet njëkohësisht në vetën e parë, në të dytën dhe në të tretën.

6. Prania e rrëfimtarëve të shumtë: Ndodh që kjo gjë alternohet gjatë rrëfimit.

7. Zakonisht skenarët janë latinoamerikanë: Kjo ndodh sepse autorët e realizmit magjik frysëzohen nga ky realitet.

8. Mitologjia dhe faktori i çuditshëm: Rrëfimet përdorin shpesh mitet, të cilët ushqejnë këtë gjini me një ngjyrë ekzotike.

9. Ambiente varfërie dhe mjerimi të skajshëm: Ngjarjet në veprat e realizmit magjik zakonisht zhvillohen në ambiente tejet të varfra ku personazhet vuajnë nga një mjerim i skajshëm. Kjo është mënyra për të njohur realitetet të ndryshme, gati të panjohura për disa, dhe qëndrimi i autorit për to.

10. Perceptim shqisori i realitetit: Autorët e realizmit magjik zakonisht i japin shumë rëndësi anës shqisore gjatë njohjes së realitetit.

11. Koha e rrëfimit: Koha është e ngatërruar dhe ngjarjet zakonisht nuk ndodhin në mënyrë të vijueshme. Ndoshta kjo është karakteristika më dalluese e realizmit magjik, gjë që e bën rrëfimin më tèrheqës për lexuesin.

Në shiritin e kohës

# ATË E BIR

François-Victor Hugo, ishte fëmijë e katërt i i Viktor Hugo-së dhe Adele Foucher. U mor më shumë me publicistikë dhe përkthime. Vdiq nga tuberkulozi në moshën 45 vjeçare

## Dashnor KOKONOZI

Tek mbërritën në vendin e ekzilit në Marine -Terrace të ishullit Jersey (ishujt Normande, territor të Anglisë), atë e bir pyetën njëri tjetrin se si do e mbushnin kohën.

Ati (Victor Hugo) :

- Unë do të vështroj oqeanin.

Pas një copë herë heshtje :

- Po ti ?

Biri (François-Victor) :

- Do të përkthej Shekspirin.

Kështu ndodhi që François-Victor i kushtoi "dymbëdhjetë vitet më të bukur të jetës së tij", siç thotë vetë, veprës së gjeniut anglez.

18 vëllimet që dolën nga duart e tij, nisën të botohen duke filluar nga viti 1859

Ajo që tha Ati ishte një mënyrë të folur.

Gjatë asaj kohe, aty në ekzil, ai shkroi: "Ndëshkimet", "Vegimet", "Legjenden e shekuve" dhe sigurisht kryeveprën e tij, "Të mjerët".

Kam një ide se përsë bëhet fjalë. Shumë vite më parë aty në Hauteville-House të ishuje Normandë, në bibliotekën e V. Hugo-së kam gjetur Serafina Topinë, librin që atij i kishte dërguar Jeronim de Rada.


Ishte finalja e një kërkimi prej shumë e shumë vitesh, që kishte filluar në Arkivin e shtetit në Tiranë, për të mësuar të vërtetën e marrëdhënieve të De Radës me V. Hugon.

(Kam disa botime të kësaj teme duke filluar nga viti '80)

François-Victor Hugo, ishte fëmijë e katërt i i Viktor Hugo-së dhe Adele Foucher. U mor më shumë me publicistikë dhe përkthime. Vdiq nga tuberkulozi në moshën 45 vjeçare, më 1873. Varri i tij ndodhet në Père-Lachaise.

Hugo nuk pati vetëm një humbje të tillë të rëndë. U përhoq ta kalojë gjithçka me punë, siç thotë vetë.

Sidoqoftë, ka shumë studiues që mendojnë se fatkeqësi të tilla e shtynë të jepet pas seancave të spiritizmit, nëpërmjet të cilave besonte se do te hynte në kontakt me njerzit e tij të dashur që nuk jetonin më.



# E. E. Cummings

## “DASHURIA IME”

dashuria ime  
flokët tu janë një mbretëri  
në të cilën mbret është errësira  
balli yt është tufë lulesh

koka jote është pyll i gjallë  
mbushur me zogj të fjetur  
gjinjtë tu janë mizëri bletash të bardha  
mbi degën e trupit tënd  
trupi yt për mua është Prill  
në sjetullat e të cilët është ardhja e pranverës  
kofshët tua janë kuaj të bardhë të lidhur për koçë  
mbretërisht  
ato janë goditje e një menestreli të mirë  
midis tyre gjithmonë është një këngë e këndshme

dashuria ime  
koka jote është kuti  
e xhevahirit të hijshëm të mendjes sate  
floku i kokës tëndë është luftëtar  
i pafajshëm në disfatë  
floku yt mbi supet tua është ushtri  
fitoresh e borish

këmbët tua janë pernë èndërrimi  
fruti i të cilës është shumë i ngrënshëm i harresës

buzët tua janë satrapë ngjyrë alli  
në puthjen e të cilëve është kombinimi i mbretërve  
kyçet e duarve tua  
janë të shenjta  
të cilat janë ruajtëse të çelësave të gjakut tënd  
këmbët tua mbi noçka janë lule në vazo  
të argjendta

në bukurinë tënde është dilema e flauteve  
sytë tu janë tradhti  
kambanash që kuptohet përmes lajkave

## KAMARADËT VDESIN NGASE KËSHTU UA KANË MBUSHUR MENDJEN

kamaradët vdesin ngase kështu ua kanë  
mbushur mendjen)

(ndjekin një gjurmë të kotë  
një zot e di pse)

kamaradët vdesin para se të plaken

edhe unë e di

(kamaradët nuk kanë frikë të vdesin

(ngase ata kanë frikë të dashurojnë

kamaradët nuk besojnë

dhe kamaradët nuk duan të besojnë

në jetë)dhe sall vdekja e di përsë

(të gjithë kamaradët mund t'i dallosh

nga altruzimi i tyre bosh

me këngën moskovite kamaradët e mirë

kércejnë)

kamaradët kënaqen

s.freud e di arysen

shpresoj nuk do ta fusni n'bela lucin

secili kamarad është një grimcë e

tërësisë së një urrejtjeje të fortë

Përktheu: Fadil Bajraj

Interpretime: Jules Laforgue

# UDHËTIMI I INKONSHOVE

Të gjitha revolucionet, si sociale po ashtu edhe kulturale, në thelb, mbeten sipërfaqësore. Gjithçka mëton në dhënien jetë hipotezave, ose në përvitjen e jetëve prej hipotezave.



(Hamdi) Erjon MUÇA

Arti poetik është i përjetshëm dhe i përbotshëm. Vetveti, ai lëviz, si në errësirë, nga një inkosho tek tetra, nga një poet i largët në kohë dhe hapësirë, tek një tjetër poet, dhe nuk mund të ndalohet nga kufijtë, të asnjë lloji. Për shembull: Montale, në fillesat e veta u influencua së tepërm nga Ungaretti, Eliot, dhe padyshim Leopardi. Ndërsa Ungaretti ishte i magjepsur pas Malarmer-s, po ashtu edhe nga Leopardi. Ndërsa Tomas Eloït, influencuesi i Montales, ishte i influencuar nga Jules Laforgue. Po jo vetëm kaq; sipas vëzhgimeve të studiues italiane, Luciana Frezza, duket sikur poetika e Montales është një përvijim, pas një pauze dyzet vjeçare, i stilit poetik, të vargut të lirë, të Laforgue, kjo e pasuruar me eksperientë e shekullit të XX. E gjitha kjo është tepër e çuditshme dhe e hatashme pasi, meqë Montale është idhulli im më i madh, dhe atë e njoh shumë mirë, Montale nuk e njihet Laforgue-n, të paktën në rrininë e tij të hershme, atëherë kur morën jetë edhe "Kocka prej sepje" ose "Rastësitë"; ndoshta me Laforgue-n është përballur më vonë, e megjithatë edhe për këtë aspekt, nëse ka ndodhur nuk kemi të dhëna të sakta. Ja pra se si arti poetike, nëpërmjet disa perceptimeve thuaqse të padukshëm, kalon nga një poet francez, i lindur në Montevideo, në Uruguai, në 1860, për më tepër i njohur dhe pëlqyer më shumë në Angli

dhe Gjermani se sa në Francë, tek një poet italian, i lindur në Xhenova më 1896. Ja pra përsë u hodha tek Jules Laforgue; arti është e vetrnja gjurmë që ne lejmë në këtë jetë. Ndërsa arsyet e dytë ka të bëjë me stilin.

Shekulli XIX ishte shekulli i revolucioneve, në kundërshtim me shekullin XX që ishte i eksperimentimeve. Ky shekull mbisundohet nga simbolika, dhe simbolika ka nevojë për shumë vargje për t'u shfaqur, në kundërshtim me vizionarizmin që mjaftohet me pak vargje. Dhe në këtë lëmsh revolutiv spikasin poetë si Laforgue apo edhe Gustav Kahn. Në fakt, në periudhën kur jetuan, këta poetë nuk spikatën edhe aq shumë, u desh ardhja e brezit të ri, për t'i dhënë vendin e merituar këtyre krijuesve të parakohshëm. Po le ta shohim më nga afër këtë poet dhe vizionarizmin e tij prehermetik.

Po, kjo botë është e sheshtë, dhe sa përtjetrën, pallavra.

Një pohim e madh, por për një pavërtetësi, në dukje. Bota fizike nuk është e sheshtë, ka kohë që kjo është konstatuar dhe vërtetuar. Bota për të cilën poeti thotë që është e sheshtë, është bota njerëzore; si të thuash, që njerëzimi është i parevolueshëm, ose nuk ka revolucion që të kapérthejë thelbësisht botëkuptimin njerëzor. Të gjitha revolucionet, si sociale po ashtu edhe kulturale, në thelb, mbeten sipërfaqësore. Gjithçka mëton në dhënien jetë hipotezave, ose në përvitjen e jetëve prej

hipotezave. Pra, Pallavra...

Pa shpresë unë endem, i paqtë, me timin fat:

përtë kaluar kohën, duke pritur vdekjen,

tymos përballë perëndive cigare të holla.

Diku në shkrimet e shenjta shkruhet se dituria largon nga besimi. Mirépo, duke fituar diturinë që largon besimin, shpresën, njeriu fiton paqen. (Dituria largon besimin nuk ka vetëm një kuptim metafizik, nuk ka të bëjë uni drejtësia vetëm me besimin shpirtëror. Kjo thënë duhet të lexohet shumëdimensionalist; me të përfshirat diturinë njeriu humb bindjet politike, besimin shpirtërorë, ndjenjën patriotike, jo më kot Wilde do të shkruante: Patriotizmi virtuty i perversëve. Njeriu i ditur nuk marshon dot në parada dhe nuk hidhet në llogore, ai jeton në paqe, dhe ia shfryt tymin, përcëmimin, në fytyrë të gjitha marrëzive njerëzore. Ngaqë me diturinë ka kuptuar atë thënien e vjetër herbraike: Natyrës i kemi hua një vdekje.

Hë, të gjallë, dihatni, o skelete të së ardhmes.

Njerëzit që rrapaten, përplasen, përliesen, a thua se janë të përjetshëm, kur edhe eshtat nuk janë të përjetshme. Dhe është i mrekullueshëm vizioni i frazës: Skelete të së ardhmes. Pak kush, kur sheh një skelet, nuk sheh vetëm një përfundim të shëmtuar të diçkaje që dikur ka jetuar; pak kush sheh në një skelet, përfundimin e dikujt që mbarti shumë emocione, bindje dhe besime; pak kush sheh përfundimin e atij që u përllesh me mish e me shprit në mbrojtje të një hipoteze, çfarëdo.

Mua, kaltërsia e honit që drejtë qillit përthyhet

më zhyt në një ekstazë të pashtershme dhe më përgjum ashtu si të vdekshmet aroma të njëmijë djegësve.

Poetin, të diturin, atij që ka fituar paqen e vëtëdies, gjithçka që e rrëthon e zhyt një thuaqje apati të kënaqshme; ngathësia kënaqësie shpëtimtare. Në atë përgjumjen e shijimit; të përjetimit të një èndrrë të bukur dhe të pashtershme. Larg nga vorbulia e flakës që djeg kërcurët në sobë, larg edhe tymit të ngrohtë, verbues dhe lotues, që del nga tymtarët, më pranë asaj gjendej ku mbetet vetëm aroma e këndshme dhe e vdekshme e drurëve të djegur, aromë këndellëse si e një gjëje të ngrënshme. E kuptuat metaforën? Ka të bëjë thuaqje me gjenezën, atëherë kur asgjë ishte e përfunduar, kur e mira dhe e keqja nuk ekziston. Atëherë kur as e keqja nuk ishte e keqe. Aty mbërrin njeriu që ka përfshirat diturinë dhe paqen.

Dhe futem në të lulëzuarin eden prej èndrrash të qarta,

ku elefantë në epsh u gërshetohen të zbehtit  
vallëzime të mushkonjave, në valcer fantastikë.

Në vargjet në vijim poeti e përforcon atë që parashtrova pak më lart. Pra, në përfitimin e dijes dhe paqes, për njeriun gjithçka është e mundur, madje edhe përjetimi i paradokseve. Me përfitimin e diturisë, njeriu përfton t'i kënaqet jetës dhe të mos frikësohet nga vdekja. Të pranojë humbjen dhe të mos ekzaltohet nga fitoret.

Dhe kur atëherë të miat vargje

mendoj dridhem,

zhibroj, zemrën plot me të emblën kënaqësi, të shtrenjtin gishtin tim të madh të skuqur si një kofshë pate.

Fitoret janë vetëm fiktive, të pjesshme, të lëvizshme dhe aspak të qëndrueshme, të gjitha, pa as më të voglin dyshim, herët a vonë, në më të mirën e mundshme derdhen në lumin e harresës, përtë mos thënë që jo pak herë, fitoret më të mëdha, në realitet kanë qenë edhe humbjet më të mëdha, por shumica këtë as që e ka kuptuar dhe as ka përtë kuptuar ndonjëherë. Këtë e kupton vetëm pakica, dhe kjo pakicë, shumë shumë e vogël edhe përtë tu quajtur pakicë, kalon e pa kuptuar nga shumica. Ndërsa në mbyllje Laforgu është shumë hermetik edhe përtë kohën që jetoi por edhe përtë ne që erdhëm më pas, dhe i vetrni shpjegim të cilin mund t'u jap, të kuptueshmë, por larg poetikës, është, që njeriu i ditur apo jo, me vëtëkënaqësi fitimtari apo me mëlef hakmarrës prej të humburi, mbetet gjithnjë me gisht në gojë. Kur do që t'i vij fundi, njeriu i do t'i ketë mbetur gjithnjë një peng i pa shlyer, pra në fund, nëse nuk do kishte njëri që t'i rregullonte kuformat, ne të së ardhmes, apo edhe të ardhshmit tanë, do të zbulonin skelete me gisht në gojë.

Tani në mbyllje dua të ndalem pak tek titulli. Pse e ka titulluar CIGARJA këtë sonet. Përmendimin tim shumë thjeshtë. Cigarja është një objekt i mbarueshëm i krijuar nga njeriu, që pjell një kënaqësi fiktive, por vrasëse. Dhe që kur mbaron dhe ti e ke hedhur në tokë, kënaqësinë nuk ta ka dhënë plotësisht. Do të doje, gjithmonë, ta thithje edhe një herë pas thithjes së fundit...

Ky është arti poetik, që lëviz në inkoshot e gjenialëve, nga njëri shekull në tjetrin, nga njëri vend në tjetrin. Ky ishte Jules Laforgue, një pararendës i psotmodernizmit në përgjithësi dhe i hermetizmit në veçanti.

## CIGARJA

Po, kjo botë është e sheshtë, dhe sa përtjetrën, pallavra.

Pa shpresë unë endem, i paqtë, me timin fat:

përtë kaluar kohën, duke pritur vdekjen,  
tymos përballë perëndive cigare të holla.

Hë, të gjallë, dihatni, o skelete të së ardhmes.

Mua, kaltërsia e honit që drejtë qillit përthyhet

më zhyt në një ekstazë të pashtershme dhe më përgjum ashtu si të vdekshmet aroma të njëmijë djegësve.

Dhe futem në të lulëzuarin eden prej èndrrash të qarta,

ku elefantë në epsh u gërshetohen të zbehtit  
vallëzime të mushkonjave, në valcer fantastikë.

Dhe kur atëherë të miat vargje

zhibroj, zemrën plot me të emblën kënaqësi, të shtrenjtin

gishtin tim të madh të skuqur si një kofshë pate.

NUMRI I ARDHSHËM MË 1 QERSHOR

# HEJZA

15 MAJ, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**  
Drejtor: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000